



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTRI

Nr. 4699/1 Prot.

Tiranë, më 21/10 /2025

URDHËR

Nr. 49/1, Datë 21.10.2025

“PËR

**MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR
VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË SISTEMIT TË KONTROLLIT TË
BRENDSHËM TË NJËSIVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe nenit 6 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Miratimin e Metodologjisë “Për Vlerësimin e Performancës së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme (NJQP)”, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Strukturat përgjegjëse që ngarkohen me matjen e treguesve të vlerësimit të performancës për çdo NjQP, janë:
 - a. Struktura përgjegjëse për Buxhetin;
 - b. Struktura përgjegjëse për Thesarin;
 - c. Struktura përgjegjëse për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
 - d. Struktura përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm.
3. Strukturat përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për financat, të ngarkuara me vlerësimin e treguesve të monitorimit të performancës së njësive publike, paraqesin informacionin e konsoliduar tek struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe

kontrollit, sipas Aneksit 2 të kësaj metodologjie, shoqëruar me raportimin përkatës në kuadër të interpretimit të indikatorëve, që secila strukturë menaxhon.

4. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit konsolidon informacionin e dërguar nga strukturat e tjera mbi vlerësimin e indikatorëve dhe raportimin përkatës mbi këta indikator, realizon rankimin vjetor të njësive të qeverisjes së përgjithshme sipas nivelit të performancës, si dhe hartimin e raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik.
5. Urdhri i Ministrit të Financave nr. 117, datë 01.04.2019, “Për miratimin e metodologjisë për Monitorimin e Performancës së Njësive Publike” dhe Urdhri nr. 221, datë 01.12.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin e Ministrit të Financave nr. 117, datë 01.04.2019, “Për miratimin e metodologjisë për Monitorimin e Performancës së Njësive Publike”, shfuqizohen.
6. Për zbatimin dhe ndjekjen e këtij Urdhri, ngarkohen strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave, të cituara në pikën 4 të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Petrit Malaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE
RAPORTIMIT FINANCIAR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E THESARIT

**METODOLOGJIA
PËR
VLERËSIMIN E PERFORMANCËS
SË SISTEMIT TË KONTROLLIT TË
BRENDSHËM TË NJËSIVE TË
QEVERISJES SË PËRGJITHSHME**

Tabela e Përmbajtjes

I. Të përgjithshme	2
II. Monitorimi i performancës së sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësive të qeverisjes së përgjithshme nga ministria përgjegjëse për financat	3
II.1 Përgjegjësitë e strukturave të ministrisë për financat në procesin e monitorimit.....	5
II.2 Afatet e raportimit dhe hartimit të raportit vjetor për funksionimin e sistemit të KBFP ...	6
III. Monitorimi nga ana e drejtuesve të njësive publike të performancës së njësive/strukturave që drejtojnë	7
IV. Treguesit e performancës.....	8
V. Procesi i përpunimit dhe leximi i rezultateve	12
Aneksi 1. Treguesit e Performancës për vlerësimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	15
Aneksi 2 Tabela e raportimit mbi vlerësimin e treguesve të performancës.....	42
Aneksi 3. Udhëzues i brendshëm si shembull për mënyren e vlerësimit të cilësisë së kontrollit të brendshëm në Njësinë e Qeverisjes së Përgjithshme (NJQP).....	43
Aneksi 4. Pyetësori i vetëvlerësimit për njësitë e auditimit të brendshëm.....	46

I. Të përgjithshme

Kontrolli i brendshëm është një instrument i qeverisjes së mirë së njësisë. Sa më funksional dhe efektiv të jetë ky sistem, aq më lartë vlerësohet niveli i qeverisjes së organizatës. Përmes tij identifikohen risqet, përmirësohet menaxhimi financiar dhe administrativ dhe garantohet respektimi i kuadrit ligjor.

Në këtë kontekst, monitorimi gjithëvjetor si dhe treguesit vjetore të performancës janë mjetet që përdoren për të gjykuar nëse një njësi e qeverisjes së përgjithshme ka një sistem të shëndoshë të qeverisjes apo nëse ka dobësi që mund të ndikojnë në integritetin, efikasitetin apo transparencën e saj.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës. Në kryerjen e monitorimit, Titullari i njësisë, Nëpunësi Autorizues dhe drejtuesit e tjerë, duhet t'i kushtojnë vëmendje gjendjes së sistemit të menaxhimit financiar dhe realizimit me eficiencë, efektivitet dhe ekonomi të shpenzimeve buxhetore në përputhje me objektivat sipas programeve dhe produkteve të planifikuara për çdo program gjatë një viti buxhetor.

Më tej, matja e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm nga ministria përgjegjëse për financat, nëpërmjet treguesve vjetore të standardizuar, shërben si një mjet për të vlerësuar cilësinë e qeverisjes në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, identifikimin e praktikave të mira, mangësive sistematike dhe nivelit të përputhshmërisë me standardet e menaxhimit publik, duke ndikuar drejtpërdrejt në formimin e gjykit mbi performancën dhe përgjegjshmërinë institucionale.

Qëllimi i kësaj metodologjie është:

- a. Përcaktimi i treguesve për matjen e performancës së njësisë së qeverisjes së përgjithshme, lidhur me cilësinë e organizimit dhe funksionimit të kontrolleve të brendshme gjatë realizimit të funksioneve publike që mbulojnë;
- b. Përcaktimi i procesit të vlerësimit të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë të qeverisjes së përgjithshme nga ana e strukturave përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për financat;
- c. Përshkrimi i metodologjisë standarde që ndjekin titullarët në kuadër të monitorimit dhe deklarimit vjetor mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të organit qendror, njësisë të vartësisë dhe njësisë publike në pronësinë apo kontrollin e institucionit që drejtojnë¹.

¹ Neni 3 i ligjit 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i rishikuar.

Kjo metodologji mund të përdoret nga drejtuesit e njësive publike për monitorimin dhe vlerësimin e performancës së sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësive/strukturave që drejtojnë në përmbushje të objektivave dhe misionit të institucionit.

II. Monitorimi i performancës së sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësive të qeverisjes së përgjithshme nga ministria përgjegjëse për financat

Ministri përgjegjës për financat është autoriteti përgjegjës për miratimin e udhëzimeve e të manualeve për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësitë publike, që mbulojnë në mënyrë të veçantë (për qëllime të këtij dokumenti) (i) formën, përmbajtjen dhe afatet për raportimin periodik te nëpunësi i parë autorizues rreth funksionimit, përshtatshmërisë, efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit ekzistues të menaxhimit financiar dhe kontrollit, parregullsitë e gjetura dhe masat e marra; (ii) formën, përmbajtjen dhe mënyrën e paraqitjes së deklaratës për cilësinë dhe kushtet e kontroleve të brendshme për vitin paraardhës².

Ministria përgjegjëse për financat vlerëson performancën e sistemit të kontrollit të brendshëm të secilës NJQP bazuar në të dhënat e siguruar nga:

1. Sistemi Informatik Financiar i Qeverise (SIFQ);
2. Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar (SIMF) për njësitë e qeverisjes qendrore;
3. Sistemi Informatik i Menaxhimit të Buxhetit (SIMB) të njësive të qeverisjes vendore;
4. Pyetësorët e vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK), të depozituara çdo vit në ministrinë përgjegjëse për financat nga Nëpunësit Autorizues të njësive të qeverisjes së përgjithshme;
5. Pyetësorët e vetëvlerësimit të veprimtarisë së auditimit të Brendshëm të NJQP-ve, të depozituara çdo vit në ministrinë përgjegjëse për financat nga njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik;
6. Raportimit mbi vlerësimin e treguesve të performancës nga secila strukturë (sipas tabelës së raportimit, Aneksi 2 i kësaj metodologjie).

Afatet e ndërmjetme të vlerësimit deri në hartimin dhe publikimin e raportit vjetor të vlerësimit të funksionimit të sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik janë si më poshtë vijon:

² Neni 6, pika 1 (b), (c) i Ligjit 10296/2010 i rishikuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

1. Çdo NJQP realizon procesin e monitorimit të brendshëm, për efekt të vlerësimit vjetor të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, gjatë periudhës Shtator-Dhjetor të vitit raportues;
2. Konsolidimi i informacionit të pyetësorëve të vetëvlerësimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe vlerësimi nga ana e NJQP, së bashku me informacionin e përmbledhur nga njësitë përkatëse të varësisë, kryhet gjatë muajve Janar –Shkurt të vitit fiskal pasardhës;
3. Deklarata e titullarit të NJQP për cilësinë e sistemit kontrollit të brendshëm, shoqëruar me raportin vjetor të Nëpunësit Autorizues, pyetësorin e vetëvlerësimit të njësisë dhe planin e veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, dërgohet në formë shkresore, pranë strukturës përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe kontrollin brenda datës 28 Shkurt të vitit fiskal pasardhës;
4. Secila strukturë përgjegjëse e ministrisë përgjegjëse për financat, kryejnë vlerësimin e treguesve të performancës sipas përkatësisë, vlerësim ky i cili përfundon në fund të muajit Prill të vitit pasardhës, përfshi këtu komunikimin me njësitë e qeverisjes së përgjithshme gjatë procesit.
5. Raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të KBFP në NJQP miratohet nga Ministri përgjegjës për financat dhe publikohet në muajin Qershor të vitit fiskal pasardhës.

Për qëllime krahasimore, në raportin e ministrisë përgjegjëse për financat për funksionimin e sistemit të KBFP, për vitin 2025, vlerësimet e mëparshme për çdo NJQP paraqiten në % ndaj nivelit optimal të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm (pikëve maksimale) për të njëjtin vit.

Informacioni i konsoliduar për çdo NJQP, është pjesë përbërëse e raportit vjetor për funksionimin e sistemit të KBFP.

Ministri përgjegjës për financat, brenda muajit Qershor të çdo viti, paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave dhe më pas në Kuvend, raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit. Ky raport, përmban informacion në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet publike për vitin buxhetor përkatës sipas natyrës ekonomike dhe funksioneve të qeverisjes, duke përfshirë këtu edhe performancën sasiore në nivel projekti dhe produkti në krahasim me buxhetin fillestar si dhe duke identifikuar arritjet dhe problemet e hasura gjatë menaxhimit dhe monitorimit të buxhetit vjetor. Raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit, i bashkëngjitet dhe raporti i vlerësimit vjetor të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme³.

³ Neni 63 i Ligjit 9936/2008 i rishikuar “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” dhe neni 18.3 i Ligjit 10296/2010 i rishikuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

Në kuadër të realizimit të përgjegjësisë si më lart, ministri përgjegjës për financat duhet të kryejë një monitorim të vazhdueshëm të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në njësite publike, për të dhënë siguri të arsyeshme që fondet publike përdoren me ekonomi, eficiencë dhe efektivitet.

II.1 Përgjegjësitë e strukturave të ministrisë për financat në procesin e monitorimit

1. Nëpunësi i Parë Autorizues (NPA) jep llogari përpara Ministrit përgjegjës për financat për monitorimin e realizuar gjatë procesit të zbatimit të buxhetit të shtetit, si dhe për monitorimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
2. Struktura përgjegjëse për buxhetin në ministrinë përgjegjëse për financat, analizon dhe vlerëson raportet e sintetizuara periodike të monitorimit të njërive të qeverisjes qendrore dhe përgatit një raport me konkluzione dhe rekomandime për secilën njësi të qeverisjes qendrore për periudhën përkatëse të raportimit. Mbështetur në informacionin e raporteve të sintetizuara të monitorimit, struktura përgjegjëse për buxhetin i rekomandon NPA të marrë masat e nevojshme korrigjuese për menaxhimin e buxhetit, në rastet kur identifikohen devijime nga planifikimi.
3. Struktura përgjegjëse për thesarin në ministrinë përgjegjëse për financat, kryen funksionet e kontrollit financiar të transaksioneve para pagesës, menaxhimin e likuiditeteve të qeverisë gjatë procesit të kryerjes së transaksioneve financiare, si dhe përgatit raporte të sintetizuara për çdo institucion qendror dhe vendor.
4. Strukturës përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, monitoron në nivel vjetor cilësinë e sistemit të MFK-së për njësitë publike raportuese. Ky monitorim kryhet nëpërmjet analizës së përgjigjeve të pyetësorëve vjetorë të vetëvlerësimit, raportit vjetor të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm të njërive të qeverisjes së përgjithshme mbi bazën dokumentare. Gjithashtu, ky monitorim vjetor merr në konsideratë nevojat për trajnim të drejtuesve dhe problematikat e ngritura nga titullarët apo drejtuesit e tjerë të njërive publike. Vlerësimi bëhet pjesë e raportit vjetor të KBFP.
5. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm ushtron funksionin e monitorimit të vazhdueshëm, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të cilësisë së veprimtarisë dhe kapaciteteve të funksionit të auditimit të brendshëm në sektorin publik në nivel kombëtar. Ky proces kryhet në vazhdimësi dhe periodikisht mbi baza vjetore dhe bazohet në instrumente dhe burime të ndryshme të të dhënave, si më poshtë:
 - a. Analizon dhe vlerëson tendencat e zhvillimit nëpërmjet shqyrtimit të planeve Vjetore dhe strategjike të NJAB-ve të krijuara , si dhe i përmbledh rezultatet në një dokument të konsoliduar për të gjithë sektorin publik;
 - b. Ndjek dhe monitoron në vazhdimësi zbatimin e planit të auditimeve, si dhe shqyrton raportet vjetore të performancës së funksionit të auditimit, duke i prezantuar në

Raportin vjetor të KBFP;

- c. Vlerëson dhe monitoron zhvillimin e kapaciteteve profesionale të strukturave të auditimit të brendshëm nëpërmjet zbatimit të programeve të trajnimit; si dhe
- d. Mbikëqyr zhvillimin e funksionimit të auditimit të brendshëm nëpërmjet vlerësimeve të jashtme të cilësisë, duke kryer verifikime në terren dhe vlerësime të përputhshmërisë në të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm.

II.2 Afatet e raportimit dhe hartimit të raportit vjetor për funksionimin e sistemit të KBFP

1. Strukturat përgjegjëse për buxhetin, thesarin, harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, harmonizimit të auditimit të brendshëm në ministrinë përgjegjëse për financat, përfundojnë vlerësimin e çdo NJQP-je brenda muajit Prill të çdo viti, lidhur me treguesit e performancës të matur sipas metodologjisë dhe përgjegjësisë të përcaktuar në seksionin II.1. Treguesit e performancës, shoqëruar me relacion shpjegues për të dhënat e raportuara, duke përfshirë në të edhe bazën krahasimore me vitet e mëparshme dhe dërgohen në rrugë elektronike tek struktura përgjegjëse e harmonizimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, e cila konsolidon informacionin dhe harton raportin vjetor të konsoliduar për cilësinë e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik brenda muajit Qershor të çdo viti.
2. Raporti vjetor i konsoliduar për KBFP, hartohet bazuar në një sistem pikëzimi për çdo tregues të përcaktuar në këtë dokument dhe për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme të monitoruar gjatë vitit, raporti vjetor i konsoliduar shoqërohet me renditjen e performancës së njësive publike, bazuar në vlerësimin e treguesve përkatës të strukturës përgjegjëse për buxhetin, thesarin, harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe harmonizimit të auditimit të brendshëm, ku identifikohen dhe njësitë me performancë më të lartë. Ky raport i dërgohet NPA për raportim tek ministri përgjegjës për financat.
3. Raporti Vjetor i KBFP, publikohet gjatë muajit Qershor në faqen e internetit të ministrisë për financat.
4. Konkluzionet dhe rekomandimet e raportit vjetor paraqiten në seancat dëgjimore të fazës strategjike të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, që organizohen në ministrinë përgjegjëse për financat, me secilën njësi të qeverisjes qendrore, sipas afateve të përcaktuara çdo vit në kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, në cilësinë e Sekretariatit të Bordit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, paraqet problematikat e ndryshme të njësive të qeverisjes së përgjithshme, të cilat diskutohen në mbledhjet e këtij bordi dhe në vijim rezultatet e analizës së performancës së njësive, të shoqëruara me rekomandimet përkatëse.

III. Monitorimi nga ana e drejtuesve të njësive publike të performancës së njësive/strukturave që drejtojnë

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të njësisë që mbulon, për performancën e produkteve të identifikuara në programin buxhetor afatmesëm, si dhe produktet për të cilat janë alokuar fondet buxhetore me buxhetin vjetor përkatës. Në këtë kuadër, ai/ajo duhet të monitorojë realizimin e objektivave nëpërmjet garantimit të një sistemi të brendshëm funksional të mbikëqyrjes dhe raportimit për matjen e performancës së veprimtarisë së njësisë dhe vlerësimin e efektivitetit të sistemit të MFK-së.

Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës dhe raporton tek Titullari për zbatimin e buxhetit vjetor dhe cilësinë e funksionimit të sistemit të MFK-së në të gjitha strukturat dhe programet/aktivitetet buxhetore, duke përfshirë monitorimin e kontrolleve të risqeve të lidhura me zbatimin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin financiar të njësisë publike.

Mbi bazën e rregullave të brendshme dhe procedurave të miratuara nga titullari, përgjegjësitë për monitorimin e performancës duhet të shpërndahen nga nëpunësi autorizues tek drejtuesit e niveleve të tjera të njësisë publike.

Çdo njësi publike mund të kryejë vetë monitorimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm për një periudhë të caktuar ose në nivel vjetor, duke konsoliduar të dhënat e mbledhura sipas treguesve të kësaj metodologjie apo për çdo tregues performance që konsiderohet i rëndësishëm për nga specifika e njësisë publike. Të dhënat duhet të përfshijnë të gjithë veprimtarinë e njësisë publike duke konsideruar edhe veprimtarinë e njësive të varësisë, si dhe raportimin nga njësitë publike të kontrolluara.⁴

Gjithashtu, pyetëtori i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK-së, është konceptuar të përdoret nga njësitë publike për vetëvlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Pyetëtori përbëhet nga pesë seksione që i përgjigjen respektivisht komponentëve të MFK-së, sipas standardeve ndërkombëtare COSO, ku komponentët përfshijnë gjithësecili, disa parime specifike. Për secilin parim janë ndërtuar një grup pyetjesh, bashkëlidhur të cilave do të jepet një përgjigje e arsyetuar dhe e justifikuar nëpërmjet paraqitjes së evidencave mbështetëse.

Nën drejtimin dhe koordinimin e Nëpunësit Autorizues, i cili në cilësinë e kryetarit të grupit të menaxhimit të riskut mbështetet në punën e tij nga koordinatorët e riskut të njësisë**, rezultatet e konsoliduara të monitorimit të performancës i raportohen Titullarit të njësisë publike.

Një shembull udhëzimi për monitorimin e brendshëm të njësive publike jepet në Aneksin 3 të kësaj metodologjie.

⁴ Njësitë e kontrolluara sipas nenit 3, pika (b), (c) të Ligjit 10296/2010 i rishikuar.

** Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.16, datë 31.12.2024 "Për koordinimin e MFK dhe funksionimit të grupit të menaxhimit të riskut në njësitë publike".

IV. Treguesit e performancës

Treguesit e performancës janë mjete matëse sasiore dhe cilësore që shërbejnë për të treguar ecurinë e njësive publike në arritjen e objektivave strategjike dhe operacionale. Ato vlerësojnë suksesin e një njësie publike ose të një aktiviteti të caktuar (siç janë projektet, programet, produktet dhe iniciativat e tjera) në të cilat kjo njësi angazhohet. Gjithashtu, këto tregues përdoren për të krahasuar situatën financiare dhe performancën ndërmjet njësive të sektorit publik.

Në këtë kontekst, ato masin ndikimin, efektet, rezultatet dhe përfundimet e procesit të vlerësimit të performancës. Procesi i identifikimit apo përcaktimit të treguesve i shërben dy qëllimeve kryesore:

1. *Ndihmon në sqarimin e objektivave*, si dhe në përcaktimin e aktiviteteve dhe hapave të nevojshëm për përmbushjen e objektivave. Për të zgjedhur treguesit, drejtuesit duhet të konsiderojnë se cilët matës të ecurisë prezantojnë më mirë përmbushjen e objektivave të institucionit/programit buxhetor/drejtorisë, duke kontribuar anasjelltas në një përcaktim më të mirë dhe më specifik të objektivave.

2. *Ndihmon procesin e monitorimit*. Monitorimi do të ndihmojë në lidhje me zbatimin e aktiviteteve, arritjen e rezultateve, menaxhimin e risqeve, shpenzimet dhe përdorimin e burimeve.

Monitorimi nënkupton:

- a. Mbledhjen sistematike dhe të vazhdueshme të informacionit;
- b. Analizimin e informacionit;
- c. Përdorimin e tij në procesin e vendimmarrjes.

Monitorimi shërben në marrjen e masave korrigjuese dhe ndihmon në përditësimin e planit të veprimit, duke ndihmuar për rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të të gjithë procesit.

Për çdo objektiv përcaktohet një ose më shumë tregues performance që masin rezultatin e lidhur me këtë objektiv.

Është e qartë se për t'i shërbyer sa më mirë qëllimit për të cilin përdoren, treguesit duhet të plotësojnë një sërë kushtesh të tjera, ndër të cilët:

- a. Të jenë specifik;
- b. Të jenë të matshëm;
- c. Të arritshëm;
- d. Realistë;
- e. Me afat të përcaktuar.

Analizimi i këtyre treguesve do të përfshijë:

- a. Përshkrimin e treguesit;
- b. Njësine matëse;
- c. Si duhet të matet në praktikë.

Metodologjia për Vlerësimin e Performancës së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme (NJQP) përfshin 24 tregues të rëndësishëm që masin efektivitetin e proceseve më të rëndësishme të njësive të qeverisjes së përgjithshme (Aneksi 1) siç janë:

1. Treguesit për matjen e përputhshmërisë dhe cilësisë së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit;
2. Treguesit për matjen e përputhshmërisë dhe cilësisë së menaxhimit të shpenzimeve publike;
3. Treguesit e efektivitetit të raportimit financiar dhe performancës;
4. Treguesit e efektivitetit të mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale;
5. Treguesit për matjen e kapaciteteve dhe cilësisë së funksionit të auditimit të brendshëm.

Përcaktimi i treguesve dhe menyra e vlerësimit referohen në kuadrin ligjor në fuqi, në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike si dhe në standarte ndërkombëtare si: Guideline Public Expenditure and Financial Accountability 2016; COSO Model ICF 2013; OECD Guideline for Assessing the Quality of Internal Control Systems 2019 (Sigma Paper No.59).

Secili tregues identifikohet me një pashaportë të veçantë, ku përcaktohen elementet e mëposhtëm:

1. Emërtimi i treguesit të performancës;
2. Përshkrimi i treguesit;
3. Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës;
4. Struktura përgjegjëse për sigurimin e të dhënave, matjen dhe raportimin e treguesit. Kjo përgjegjësi e caktuar përfshin gjithashtu llogaridhënien për vlefshmërinë /cilësinë e të dhënave;
5. Frekuenca e publikimit të të dhënave;
6. Referenca e kuadrin ligjor/ standardin ndërkombëtar të vlerësimit;
7. Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit;
8. Përshkrimi i metodës së matjes.

Një pamje e përgjithshme e treguesve të performancës për matjen e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm jepet në tabelën e mëposhtme.

Pashaportat e secilit tregues jepen në Aneksin 1 të metodologjisë.

Emërtimi i Treguesit	Struktura përgjegjëse në MF për matjen dhe raportimin e treguesit	Total 138 pikë Maksimumi i Pikëve për secilin tregues.
----------------------	---	--

Matja e përputhshmërisë dhe cilësisë së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit		
1. Realizimi i shpenzimeve korente të njësisë publike kundrejt buxhetit fillestar të miratuar në Kuvend/Këshill	Struktura përgjegjëse për buxhetin	4
2. Realizimi i shpenzimeve korente sipas klasifikimit ekonomik	Struktura përgjegjëse për buxhetin	4
3. Realizimi i shpenzimeve kapitale të njësisë publike sipas klasifikimit ekonomik	Struktura përgjegjëse për buxhetin	4
4. Përqindja e projekteve të reja të investimeve të papërfshira në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) më të fundit	Struktura përgjegjëse për buxhetin	8
Matja e përputhshmërisë dhe cilësisë së menaxhimit të shpenzimeve publike		
5. Reduktimi i nivelit të detyrimeve të prapambetura	Struktura përgjegjëse për buxhetin	8
6. Të gjitha faturat janë dërguar në kohë për pagesë pranë degës përkatëse të thesarit	Struktura përgjegjëse për thesarin	3
7. Të gjitha angazhimet shumëvjeçare janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit	Struktura përgjegjëse për thesarin	4
8. Të gjitha angazhimet janë ekzekutuar brenda periudhës së miratuar në momentin e nënshkrimit të kontratës	Struktura përgjegjëse për thesarin	4
9. Intensiteti i shpenzimeve publike në fund të vitit fiskal	Struktura përgjegjëse për thesarin	4
10. Parashikimi dhe rishikimi i planit mujor të arkës	Struktura përgjegjëse për thesarin	8
Matja e efektivitetit të raportimit financiar dhe raportimit për performancën.		
11. Plotësia dhe krahasueshmëria e raporteve periodike për monitorimin e buxhetit	Struktura përgjegjëse për buxhetin në MF	24
12. Paraqitja, nënshkrimi dhe respektimi i afatit kohor të dorëzimit të pasqyrave financiare sipas kuadrit ligjor në fuqi	Struktura përgjegjëse për thesarin (Drejtoria e Përgjithshme)	10
13. Hartimi me cilësi i Planit të Veprimit të	Struktura përgjegjëse për	4

MFK-së dhe paraqitja sipas detyrimeve ligjore	harmonizimin e MFK-së	
14. Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFK-së	4
Matja e efektivitetit të mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale		
15. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë filozofinë dhe stilin e punës së drejtuesit, mënyrën se si drejtuesi shpërndan detyrat dhe ngarkon përgjegjësitë në njësi	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së	4
16. Menaxhimi i riskut është pjesë integrale e veprimtarisë së njësive publike	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së	4
17. Njësia publike përzgjedh, zhvillon aktivitete kontrolli përmes politikave, procedurave të shkruara.	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së	4
18. Njësia publike përzgjedh, zhvillon sisteme të informacionit dhe komunikimit	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së	4
19. Njësia publike përzgjedh, zhvillon sisteme të monitorimit	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së	4
20. Zbatimi i rekomandimeve të Auditimit të Brendshëm	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e Auditimit të Brendshëm	4
Matja e kapaciteteve dhe cilësisë së funksionit të auditimit të brendshëm		
21. Sigurimi i shërbimit dhe kapacitetet e Auditimit të Brendshëm.	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e Auditimit të Brendshëm	5
22. Pranimi i rekomandimeve të AB	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e Auditimit të Brendshëm	4
23. Natyra e Auditimeve dhe Standardet e Aplikuara	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e Auditimit të Brendshëm	10
24. Cilësia e përgatitjes së Raportit vjetor të NJAB-ve	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e Auditimit të Brendshëm	6

V. Procesi i përpunimit dhe leximi i rezultateve

Procesi i vlerësimit për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme kalon nëpër hapat ose fazat e mëposhtme:

Hapi 1. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit kryen mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi treguesit e performancës për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme. Brenda muajit Tetor të çdo viti, në bazë të detyrimit për mbledhjen e të dhënave nga NJQP-të, struktura përgjegjëse për buxhetin vë në dispozicion për strukturën përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, listën e NJQP-ve të vitit aktual. Brenda muajit Nëntor të çdo viti i kërkohet të gjithë nëpunësit autorizues të NJQP-ve për realizimin e raportimit vjetor, si dhe strukturave përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për financat që të sigurojnë të dhënat e nevojshme për vlerësimin e treguesve respektivë të performancës sipas listës së njësive të dërguara nga struktura përgjegjëse për buxhetin.

Hapi 2. Vlerësimi paraprak dhe përfundimtar për çdo tregues performance deri në fund të muajit Prill.

Strukturat përgjegjëse të ministrisë së financave sigurojnë të dhënat e nevojshme dhe kryejnë vlerësimin e treguesve. Më pas struktura përgjegjëse e cila përmbledh informacionin njofton elektronikisht nëpunësin autorizues të NJQP lidhur me vlerësimin paraprak të treguesve duke përcaktuar afatin kohor për përgjigje/komente/sqarime/sigurim dokumentacioni shtesë.

Çdo tregues performance matet me një numër të caktuar pikësh sipas metodologjisë së përshkruar hollësisht në pashaportën e treguesit (Aneksi 1).

Matësit e treguesve shprehen kryesisht në dy forma:

- Pyetje PO/JO me 1 dhe 0 pikë;
- Raporte vlerore dhe sasiore të shprehura në përqindje, të cilat vlerësohen me një sistem pikësh nga 0 deri në 4 sipas intervaleve brenda diapazonit 0-100% të përcaktuara qartësisht në pashaportën e secilit tregues.

Hapi 3. Vlerësimi i konsoliduar për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme dhe renditja e njësive sipas efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Strukturat përgjegjëse të Ministrisë përgjegjëse për financat menaxhojnë të gjitha informacionet specifike për çdo njësi, në kuadër edhe të vlerësimit që realizojnë dhe dërgojnë elektronikisht në strukturën e harmonizimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, brenda muajit Prill të çdo viti, treguesit e performancës të vlerësuar për çdo NJQP, sipas Aneksit 2, shoqëruar me relacionin shpjegues dhe krahasues për të dhënat statistikore të raportuara dhe/ose komente/sqarime për secilin indikatorë në bazë të grupeve të njësive të qeverisjes së përgjithshme me specifika për njësi të veçanta ku gjykohet e vlefshme.

Në vazhdimësi, të dhënat do të përpunohen sipas sistemeve manuale të kombinuar me programe të thjeshta kompjuterike dhe do të shihet nëse ekziston mundësia e ndonjë mangësie apo gabimi në raportim, të cilat do t'ju dërgohen përsëri për verifikim strukturave përgjegjëse përkatëse.

Së fundmi do të kryhet analizimi i detajuar i përmbajtjes së të gjithë dokumentacionit të dërguar nga strukturat përgjegjëse, dhe do të llogaritet shumatorja e pikëve të 24 treguesve të performancës për çdo NJQP.

Hapi 4. Llogaritet niveli i përmbushjes së kërkesave ligjore për një sistem efektiv të kontrollit të brendshëm në NJQP: Raporti i shprehur në përqindje (%) i shumës totale të pikëve të përftuara nga njësia, kundrejt totalit të pikëve maksimale të gjithë treguesve (kërkesat standarde për një sistem efektiv të KB).

Leximi përfundimtar i rezultatit për çdo NJQP kryhet, duke iu referuar metodologjisë PEFA 2016, si më poshtë vijon:

Totali i pikëve maksimale të 24 treguesve të performancës, **gjithsej 138 pikë**, përbën standardin optimal për t'u arritur nga njësitë publike për të ofruar siguri të arsyeshme taksapaguesve shqiptarë, donatorëve dhe kreditorëve të qeverisë, që burimet financiare publike menaxhohen me efektivitet, eficiencë dhe ekonomi duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë.

- **Sistem me Efektivitet të Lartë.** Kërkesat konsiderohen të plotësuara kur vlerat e treguesit rezultojnë 90 % ose më shumë.
- **Sistem Efektiv.** Shumica e kërkesave konsiderohen të plotësuara kur vlerat e treguesit rezultojnë 75 % ose më shumë.
- **Sistem Pjesërisht Efektiv.** Një pjesë e madhe e kërkesave plotësohet kur vlerat e treguesit rezultojnë 50 % ose më shumë.
- **Sistem Jo Efektiv.** Disa kërkesa janë plotësuar kur vlerat e treguesit rezultojnë 25 % ose më shumë.
- **Sistem me Dobësi të Theksuara.** Pak kërkesa janë plotësuar kur vlerat e treguesve rezultojnë me pak se 25 %.

Hapi 5. Rezultati i përftuar paraqitet në renditjen e përgjithshme të njësive të qeverisjes së përgjithshme, i krahasuar me të dhënat e një ose dy viteve të mëparshme.

Rezultatet e këtij vlerësimi do të paraqiten në Raportin Vjetor mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme. Për qëllime statistikore dhe krahasuese sipas sektorëve, ministria përgjegjëse për financat mund të paraqesë në raportin vjetor renditjen e njësive të qeverisjes qendrore dhe të vetëqeverisjes vendore në dy tabela të veçanta.

Hapi 6. Raporti vjetor i konsoliduar i funksionimit të sistemit të KBFP publikohet në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për financat.

Hapi 7. Ky raport dhe gjetjet kryesore të tij do t'i prezantohen Këshillit të Ministrave dhe do të diskutohen në Parlament gjatë seancave të miratimit të buxhetit faktik.

MINISTRI

Petrit Malaj



Aneksi 1. Treguesit e Performancës për vlerësimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme

1 Grupi i treguesve për matjen e përputhshmërisë dhe cilësisë së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit

1 Treguesi i Performancës	Realizimi i shpenzimeve korente të njësisë publike kundrejt buxhetit fillestar të miratuar në Kuvend/Këshill	
Pershkrimi i treguesit	Ky tregues vlerëson cilësinë e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme (qëndrore ose vendore). Ai përcakton masën në %, të realizimit të shpenzimeve të njësisë gjatë një viti fiskal kundrejt <u>buxhetit fillestar</u> të miratuar nga Kuvendi/Këshilli i NJVV për të njëjtën periudhë. <u>Buxheti fillestar</u> i njësisë publike qëndrore është plani i shpenzimeve të parashikuara për tu realizuar nga njësia gjatë vitit fiskal raportues (t), miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin fillestar të buxhetit të shtetit (dhjetor viti t-1). <u>Buxheti fillestar</u> i njësisë publike të vetëqeverisjes vendore është plani i shpenzimeve të parashikuara për tu realizuar nga njësia gjatë vitit fiskal raportues (t), miratuar nga Këshilli Bashkiak / Qarkut me vendimin fillestar të buxhetit të NJVV (muaji dhjetor viti t-1).	
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të sigurohen nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ)	
Struktura përgjegjëse për sigurimin e të dhënave, matjen dhe raportimin e treguesit.	Struktura përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave	
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore	
Referenca në kuadrin ligjor/ standard ndërkombëtar	PEFA ^{††} , PI-1 Rezultati i shpenzimeve agregate	
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Përqindja e realizimit: Raporti në % i totalit të shpenzimeve vjetore të kryera nga njësia publike, kundrejt buxhetit fillestar të njësisë për të njëjtën periudhë.	
	% e realizimit	Pikëzimi Totali 4 pikë
	95%-105%	4
	(90%-94%); (106%-110%)	3
	(85%-89%); (111%-115%)	2
	(80%-84%); (116%-120%)	1

^{††} PEFA – Public Expenditure and Financial Accountability, Program i krijuar nga Komisioni Europian, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore për matjen dhe raportimin mbi performancën e menaxhimit financiar publik.

	nen 50%; mbi 120%	0
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues llogaritet si raport i totalit të shpenzimeve të realizuara nga njësia publike gjatë vitit fiskal raportues me buxhetin fillestar të miratuar nga Kuvendi / Këshilli i njësise vendore për të njëjtin vit fiskal. Njësia vlerësohet me 0 pikë qoftë për mosrealizimin e shpenzimeve nën 50% të buxhetit fillestar të vitit raportues, qoftë për tejkalim të shpenzimeve përtej masës 120% të buxhetit fillestar të vitit raportues. Për vlerat e ndërmjetme referohuni në vlerësim sipas tabelës.	

2. Treguesi i Performancës	Realizimi i shpenzimeve korente sipas klasifikimit ekonomik.		
Përshkrimi i treguesit	Ky tregues përcakton masën në % të devijacionit midis buxhetit fillestar dhe shpenzimeve faktike/të realizuara nga njësia publike në fund të vitit raportues, sipas klasifikimit ekonomik (paga, sigurime, shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes, subvencione, transfertat, interesa financiare, kapitale të trupëzuara dhe të patrupëzuara, huadhënie, pjesëmarrje në kapital).		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të sigurohen nga SIFQ.		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen/vlerësimin e të dhënave	Struktura përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca në kuadrin ligjor/ standard ndërkombëtar	PEFA, PI-2.2 Rezultati i shpenzimeve sipas përbërjes		
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Përqindja e devijimit total llogaritet si: Raporti i devijimit total të shpenzimeve korente, sipas klasifikimit ekonomik, me planin e rregulluar, në %.	%	Pikëzimi Totali 4 pikë
		< se 5%	4
		5%-9.99%	3
		10%-14.99%	2
		15%-20%	1
		mbi 20%	0
Përshkrimi i metodës së matjes dhe vlerësimit	Pëllogaritja e treguesit bëhet sipas tabelës PEFA PI-2.2 për llogaritjen e devijacionit të shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik: https://www.pefa.org/resources/calculation-sheets-pefa-performance-indicators-pi-1-pi-2-and-pi-23-november-2018. Vlerësimi me pikë kryhet kundrejt intervaleve në % të treguara në tabelën e treguesit më sipër. Njësia vlerësohet me 4 pikë nëse devijacioni rezulton më i vogël se 5%.		

Tabela për llogaritjen e devijacionit të shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik

Emërtimi i shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik	Buxheti Fillestar i Njesisë*	Shpenzimet e realizuara gjatë vitit/ Fakti **	Buxheti i rregulluar i Njesisë***	Devijimi absolut ****	% Devijimit e
Pagat					
Kontributet e Sigurimeve Shoqërore					
Mallra dhe Shërbime					
Subvencionet					
Të tjera transfertë korrente të brendshme					
Transfertë korrente të huaja					
Transfertë për Buxhetet Familjare dhe Individët					
Shpenzimet Kapitale për aktive të trupëzuara					
Shpenzime kapitale për aktive të trupëzuara					
Transfertë kapitale					
Shpenzime për huadhënie /pjesëmarrje në kapital					
TOTALI	Buxheti Total i miratuar	Totali i Realizimit faktik	Totali i Buxhetit të Rregulluar	Devijimi Total	Devijimi Total në % *****

*Plani Fillestar i buxhetit duke shtuar planin për fondet e planifikuar në ligj për t'u shpërndarë si Fondi i Veçantë, Rritja e Pagave, Indeksi i pensioneve etj.

** Realizimi faktik i shpenzimeve duke përfshirë fondet e akorduara nga F. Rezervë.

*** Buxheti i rregulluar llogaritet duke shumëzuar buxhetin fillestar për çdo kategori shpenzimesh me koeficientin në % të realizimit të shpenzimeve në total (Koeficienti në % = Total Fakt/Total buxhet fillestar)

**** Devijimi absolut llogaritet si diferencë absolute e realizimit faktik me buxhetin e rregulluar.

***** Devijimi total në % llogaritet si raport në % i Devijimit Total/Buxhetin e rregulluar.

3. Treguesi i Performancës	Realizimi i shpenzimeve kapitale të njësisë publike sipas klasifikimit ekonomik
	Treguesi mat devijimin midis shpenzimeve buxhetore kapitale të planifikuara (sipas buxhetit fillestar) dhe shpenzimeve kapitale faktike në fund të vitit raportues.

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga SIFQ		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen/vlerësimin e të dhënave	Struktura përgjegjëse për buxhetin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca ligjore/ standardi ndërkombëtar	Pasaporta e Indikatorëve të SIGMA dhe Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike		
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Përqindja: Devijimi nga plani fillestar i realizimit i shpenzimeve kapitale në një vit/shpenzimet kapitale totale të planifikuara me ligjin e buxhetit vjetor në Kuvend/Këshillin e NJVV	%	Pikëzimi Totali 4 pikë
		<2%	4
		2%-4.99%	3
		5%-9.99%	2
		10%-15%	1
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues llogaritet si raport i shpenzimeve kapitale në një vit me shpenzimet kapitale të planifikuara me ligjin e buxhetit vjetor në Kuvend/Këshillin e NJVV. Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 10%-15%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 1 pikë; Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 5 %-9.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 2 pikë; Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 2%-4.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 3 pikë; Nëse vlera e këtij raporti (në %) është më e vogël se 2%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 4 pikë.		

4. Treguesi i Performancës	Përqindja e projekteve të reja të investimeve të papërfshira në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) më të fundit		
	Treguesi mat nivelin e integritetit të projekteve të investimeve në planifikimin shumevjeçar i shprehur në sasi dhe vlerë për NJQQ-të. Pjesa më e madhe e projekteve të zbatuara janë regjistruar bazuar në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA).		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga SIFQ, dhe PBA në SIMF dhe përkatësisht për njësitë qendrore.		
Struktura përgjegjëse për vlerësimin e të dhënave	Struktura përgjegjëse për buxhetin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca ligjore/ standardi ndërkombëtar	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë".		

Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Përqindja: numri total i projekteve të reja të paplanifikuara në PBA/numrit total të projekteve të detajuara në buxhetin fillestar të vitit korrent.	%	Pikëzimi Totali 8 pikë
		<4.99%	4
		5%-9.99%	3
		10%-14.99%	2
		>15%	1
	Raport në %: Vlera e projekteve të reja të paplanifikuara në PBA, kundrejt vlerës totale të projekteve të investimeve sipas buxhetit fillestar për vitin korrent.	0%	4
		<2%	3
		2%-10%	2
		10%-15%	1
		mbi 15%	0
Përshkrimi i metodës së matjes dhe vlerësimit.	Sa më e lartë përqindja, aq më e ulët është cilësia e planifikimit. Një përqindje e ulët nënkupton se projektet janë të planifikuara më herët, të integruara në ciklin e programimit shumëvjeçar dhe kanë kaluar përmes proceseve institucionale të analizës dhe prioritizimit në EMP dhe GMS. Vlerësimi më i lartë me 4 pikë i jepet njësisë, që ka integruar në PBA të gjitha projektet e investimeve dhe i përmbahet planifikimit fillestar në zbatim.		

2 Grupi i treguesve për matjen e përputhshmërisë dhe cilësisë së menaxhimit të shpenzimeve publike

5. Treguesi i Performancës		Reduktimi i nivelit të detyrimeve të prapambetura	
Përshkrimi i Treguesit	Treguesi mat nivelin e menaxhimit të shpenzimeve publike me fokus në risqet e njësisë. Niveli i reduktimit të detyrimeve të prapambetura shprehet si diferencë e stokut 12-mujor të detyrimeve të prapambetura të vitit fiskal korrent me stokun 12-mujor të vitit paraardhës në raport me stokun 12-mujor të vitit paraardhës.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të sigurohen nga SIFQ dhe raportet vjetore të njësive publike		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen/vlerësimin e të dhënave	Struktura përgjegjëse për buxhetin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca ligjore/ standardi ndërkombëtar	PEFA, PI-22 – Detyrime financiare të prapambetura për shpenzimet. Ligji 9936/2008 i rishikuar “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH”.		
		%	Pikëzimi

Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	% e stokut të detyrimeve të prapambetura kundrejt totalit të shpenzimeve vjetore të planifikuara në fillim viti, të njësisë është e papërfillshme.		Totali 8 pikë
		0% - 0.1%	4
		<-20%	4
		-20% deri -5%	3
		-5% - 0%	2
		0%	1
	Përqindja: Diferenca e stokut 12-mujor të detyrimeve të prapambetura të vitit fiskal korrent me stokun 12-mujor të vitit paraardhës në raport me stokun 12-mujor të vitit paraardhës.	>0%	0
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues llogaritet mbi bazën e dy kriterëve: <u>Kriteri 1:</u> Njësia vlerësohet me performancë maksimale nëse ka nën kontroll riskun e detyrimeve të prapambetura deri në nivelin 0.1% të shpenzimeve totale të vitit korrent/raportues. <u>Kriteri 2:</u> Nëse njësia nuk plotëson kriterin e mësipërm atëherë vlerësohet sipas diferencës së stokut 12-mujor të detyrimeve të prapambetura të vitit buxhetor korrent me stokun 12-mujor të vitit paraardhës pjesëtuar me stokun 12-mujor të vitit paraardhës. Në rastet kur treguesi është pozitiv d.m.th qw ka keqmenaxhim tw theksuar tw riskut, tregon që institucionet rezultojnë me stok të rritur të detyrimeve të prapambetura dhe vlerësohen me 0 pikë. Në rastet kur treguesi rezulton 0% ose negativ vlerësimi kryhet sipas pikëzimit në tabelën e mësipërme. Në rast se treguesi është më i vogël se -20% (p.sh -21%, -30%, etc), atëherë njësia vlerësohet me pikë maksimale për menaxhimin e riskut gjatë vitit raportues.		

6. Treguesi i Performancës	Të gjitha faturat janë dërguar në kohë për pagesë pranë degës përkatëse të thesarit.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat nivelin e përgjegjshmërisë menaxheriale gjatë zbatimit të buxhetit (zbatimi i kontratave sipas planifikimit buxhetor dhe menaxhimi i risqeve të lidhura): -Të gjitha faturat e pranuar nga njësia publike, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës të pranimit të mallrave/shërbimeve/objekteve, duhet të paraqiten në kohën e duhur në degën e thesarit, me qëllim shlyerjen e detyrimit financiar brenda periudhës së përcaktuar në kontratë, minimumi 30 ditë sipas përcaktimeve ligjore. -Treguesi vlerëson pagesat për mallrat, shërbimet dhe punët e pranuar në raport me periudhën e përfundimit të tyre sipas kontratës. Koha nga data e mbylljes së kontratës (përfundimi i objektit dhe pranimi i tij) deri në datën e pagesës së fundit nuk duhet të tejkalojë 60 ditë.
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Një raport i gjeneruar nga SIFQ do të tregojë të gjitha faturat e paguara të njësisë publike gjatë vitit raportues, shoqëruar me tregues të numrit të ditëve të kaluara nga data e faturave të pranuar deri në kryerjen e pagesës.

Struktura përgjegjëse për nxjerrjen/vlerësimin e të dhënave	Struktura përgjegjëse për thesarin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligji nr.48/2014 Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregëtare.		
			Pikëzimi Totali 3 pikë
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Raporti (%) i numrit i faturave të paguara pas 60 ditëve nga data e faturave të pranuar/ numrin total të faturave për cdo NJQP.	<2%	3
		2%-4.99%	2
		5%-9.99%	1
		10%<	0
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues i vlerësuar nga 0 në 3 pikë, llogaritet si më poshtë: Maksimumi 3 pikë: Raporti, i shprehur në %, i numrit të faturave të dërguara për pagesë pas afatit kohor prej 60 ditësh nga data e pranimi të tyre (si rregull duhet të përputhet me datën e lëshimit nga furnitori), me numrin total të faturave të regjistruara në SIFQ gjatë vitit raportues. - Nëse vlera e raportit është më e madhe se 10%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 0 pikë; - Nëse vlera e raportit është më e vogël se 2%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 3 pikë. - Për vlerat e ndërmjetme ndiqet logjika siç shihet në tabelë.		

7. Treguesi i Performancës	Të gjitha angazhimet shumëvjeçare janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat nivelin e përgjegjshmërisë menaxheriale në menaxhimin e kontratave dhe parashikueshmerinë e kryerjes së shpenzimeve me efekt në disponueshmerinë e mjeteve monetare. Njësitë duhet të jenë në gjendje të planifikojnë dhe angazhojnë shpenzimet për të paktën një muaj përpara pagesës në përputhje me alokimet buxhetore dhe planin e arkës. Matja kryhet nëpërmjet monitorimit të periudhës nga momenti i regjistrimit të angazhimit në degën e thesarit deri në paraqitjen/rregjistrimin e urdher shpenzimit në degën e thesarit (momenti i lëshimit të faturës në SIFQ). Angazhimet përfshijnë kontratat, marrveshjet dhe çdo dokument tjetër mbi bazën e të cilit njësia do të kryejë shpenzim në të ardhmen.
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Një raport i gjeneruar nga SIFQ për vitin raportues do të tregojë për çdo NJQP (nivel entiti), të gjitha datat e nënshkrimit të angazhimeve si dhe datat e lëshimit të tyre në sistem gjatë vitit raportues.
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për thesarin

Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca ligjore/ standardi ndërkombëtar	PEFA, PI 21.3 – <i>Informacion për angazhimet e marra</i> . Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"		
		%	Pikëzimi Total 4 pikë
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Për kontratat shumëvjeçare: Raporti në % i numrit të angazhimeve të regjistruara në SIFQ mbi 120 ditë përpara datës së leshimit të parë të kontratës (lëshimi i parë i lidhur me faturën)/ numrin total të angazhimeve shumëvjeçare.	mbi 90%	4
		81%- 90%	3
		71%-80%	2
		nën 70%	0
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues vlerësohet nga 0 deri 4 pikë në varësi të intervalit ku figuron rezultati i shprehur në %. Pragu i vlerësimit është i lartë 70%, që tregon rëndësinë që ka kërkesa e ligjit për moslejimin e surprizave në menaxhimin e mjeteve monetare, si krijimi i pagesave të prapambetura, etj.		

8. Treguesi i Performancës	Të gjitha angazhimet janë ekzekutuar brenda periudhës së miratuar në momentin e nënshkrimit të kontratës.
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat nivelin e përgjegjshmërisë menaxheriale në menaxhimin e kontratave, në përputhje me fondet buxhetore të planifikuara për ekzekutimin e tyre. Njësitë duhet të jenë në gjendje të planifikojnë fondet dhe të sigurojnë disponueshmërinë e tyre në përputhje me afatet e ekzekutimit të angazhimeve për shpenzime (kontrata). Ky tregues ndihmon gjithashtu në procesin e eliminimit të krijimit të pagesave të vonuara. Matja kryhet përmes monitorimit të diferencave kohore midis datës së përfundimit të kontratës dhe datës së pagesës së fundit të planifikuar dhe të regjistruar në SIFQ.
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Një raport i gjeneruar nga SIFQ për vitin raportues do të tregojë për çdo NJQP dhe në nivel entiteti), të gjitha kontratat ku diferenca kohore ndërmjet datës së përfundimit të kontratës dhe datës së faturës së fundit të planifikuar të saj (rreshti i shpërndarjes së fundit të kontratës rregjistruar në SIFQ) është më e vogël se 0. Pra, nëse kjo diferencë është me vlerë negative do të thotë që pagesa e fundit e planifikuar për kontratën është përtej datës së përfundimit të kontratës. Ndërsa ku vlera e kësaj difference është pozitive do të thotë që pagesat e kontratës janë planifikuar brenda kohës së përfundimit të kontratës.
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për thesarin

Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca ligjore/ standardi ndërkombëtar	PEFA, PI 21.3 – <i>Informacion për angazhimet e marra</i> . Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"		
		%	Pikëzimi Total 4 pikë
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Raporti në % i numrit të angazhimeve të regjistruara në SIFQ me diferencë kohore > 0 / numrin total të angazhimeve.	< 1%	4
		1% > 5%	2
		5% > 10%	1
		> 10%	0
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues vlerësohet nga 0 deri 4 pikë.. Pikëzimi për intervalet e caktuara ndjek logjikën sic tregohet në tabelë. Pragu i vlerësimit është i ulët 10%, që tregon rëndësinë që ka kërkesa e ligjit për moslejimin e surprizave në menaxhimin e angazhimeve, planifikimin e fondeve buxhetore të lidhura me to, krijimin e pagesave të prapambetura, etj.		

9. Treguesi i Performancës		Intensiteti i shpenzimeve publike në fund të vitit fiskal.	
Përshkrimi i Treguesit	Ky tregues mat nivelin e menaxhimit të shpenzimeve publike dhe përgjegjshmërisë menaxheriale të njësive të qeverisjes së përgjithshme, duke u bazuar në përqindjen e shpenzimeve të kryera gjatë dy muajve të fundit të vitit fiskal. Një përqindje shumë e lartë në fund të vitit mund të tregojë ekzekutim të ngadaltë të buxhetit ose kontrole të brendshme joefektive në njësitë përkatëse, me pasoja në parashikimin e flukseve të parasë (planin e arkës) dhe deri te rritja e kostove të huamarrjes së qeverisë.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës.	Një raport i gjeneruar nga SIFQ do të tregojë shpenzimet e kryera në dy muajt e fundit të vitit raportues, si dhe totalin e shpenzimeve të çdo njësie publike (nivel entiteti) për të njëjtin vit.		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen/vlerësimin e të dhënave	Struktura përgjegjëse për thesarin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca ligjore/standardi ndërkombëtar	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë". Ligji 10296/2010, i rishikuar "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Udhëzuesit e FMN (1/07/1999) dhe OECD (20/03/2001) për menaxhimin e shpenzimeve publike		
		%	Pikëzimi Totali 4 pikë
		<20%	4

Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Raporti në përqindje i shumës së shpenzimeve të njësisë publike në muajt nëntor dhe dhjetor të vitit raportues, në krahasim me totalin e shpenzimeve të kryera nga njësia gjatë të njëjtë vit raportues.	20%<25%	3
		25%<35%	2
		35-40%	1
		>40%	
Përshkrimi i metodës së matjes dhe vlerësimi	Ky tregues llogaritet në përqindje dhe njësia publike vlerësohet me pikë. Përqendrimi i theksuar i shpenzimeve në fund të vitit (mbi 40%) tregon keqmenaxhim të parësë publike dhe njësia vlerësohet me 0 pikë. Raporti deri 20% tregon një shpërndarje normale të shpenzimeve gjatë vitit fiskal, si rrjedhim një menaxhim optimal të parësë publike: pra ecuri normale të procesit të prokurimeve, kryerje të shërbimeve dhe monitorim të vazhdueshëm të zbatimit të buxhetit nga ana e menaxhimit të lartë. Njësia në këtë rast vlerësohet me 4 pikë. Përqindjet e ndërmjetme ndjekin logjikën e pikezimit.		

10. Treguesi i Performancës	Parashikimi dhe rishikimi i planit mujor të arkës		
	Nëpunësi zbatues i NJQP të hartojë në kohë dhe sistematikisht parashikime të besueshme të flukseve të arkës për muajt e ardhshëm, bazuar në arkëtimet dhe pagesat e pritshme. Treguesi mat vlerën e avancimeve nga njësitë shpenzuese kundrejt totalit të planit vjetor të arkës.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Një dokument në Excel i përgatitur nga struktura përgjegjëse për drejtimin e likuiditetit në qendër për qeverisjen qendrore dhe nga struktura përgjegjëse për Thesarin në degë për qeverisjen vendore.		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për thesarin		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Periodike		
Referenca	Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, për çeljen dhe mirëmbajtjen e të dhënave të operatorëve ekonomikë, dhe në vijim të tij, udhëzimi plotësues i përvitshëm. Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike.		
		%	Pikëzimi Totali 8 pikë
	Frekuenca e përditësimit të planit të arkës: - Njësia raporton vetëm në fillim të vitit - Njësia raporton sipas rastit - Njësia raporton çdo dy muaj -Njësia raporton në datën 25 të çdo muaji		1
			2
			3
			4
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Përqindja: Vlera e avancuar/ vlera vjetore e planit të arkës	<10%	4
		10%-11.99%	3

		12%-14.99%	2
		>15%	1
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues përbëhet nga dy nëntregues që reflektojnë cilësinë e menaxhimit të mjeteve monetare të njësisë. Nëntreguesi 1 është sasior dhe bazohet në shpeshtësinë e raportimit, ku raportimi frekuent merr pikë maksimale. Nëntreguesi i dytë llogaritet si raport i vlerës së avancimeve të kryera gjatë vitit nga njësitë shpenzuese me totalin e planit vjetor të arkës. Nëse vlera e këtij raporti (në %) është më e madhe se 15%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 1 pikë; Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 12%-14.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 2 pikë; Nëse vlera e këtij raporti (në %) përfshihet në intervalin 10%-11.99%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 3 pikë; Nëse vlera e këtij raporti (në %) është më e vogël se 10%, vlerësimi sipas metodologjisë do të jetë 4 pikë.		

3 Grupi i treguesve për matjen e efektivitetit të raportimit financiar dhe raportimit për performancën.

11. Treguesi i Performancës	Plotësia dhe krahasueshmëria e raporteve periodike për monitorimin e buxhetit
	Ky tregues vlerëson nivelin e përputhshmërisë dhe cilësinë e raporteve të monitorimit të buxhetit të njërive të qeverisjes qendrore dhe vendore, nëpërmjet matjes së kriterëve të mëposhtme: - Mbulimi dhe klasifikimi i të dhënave lejon krahasimin e drejtpërdrejtë me buxhetin fillestar. Informacioni i shpenzimeve përfshin të gjithë zërat e buxhetuara. Informacioni i shpenzimeve mbulohet si në fazën e angazhimit ashtu edhe në atë të kryerjes së shpenzimit. - Gjithëpërfshirja: gjithë njesite shpenzuese të njësisë publike (jo vetëm aparati). - Krahasueshmëria me periudhat e kaluara dhe deviacionet për produktet dhe projektet e planifikuara. - Koha e përgatitjes, raportimit dhe publikimit.
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raportet e monitorimit të paraqitura nga NJQP; Moduli i BPPM i AFMIS për NJQQ; sistemi SMBV për NJQV.
Struktura përgjegjëse për vlerësimin e të dhënave	Struktura përgjegjëse për buxhetin në MF
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore
Referenca ligjore/ standardi ndërkombëtar	PEFA, PI-28 Raportet Periodike të Buxhetit Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimet e MF për monitorimin e buxhetit të NJQQ dhe NJQV.

Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Analiza dhe gjykimi i specialistëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit mbi informacionin e paraqitur në përmbushje të kriterëve të vlerësimit të treguesit, si më poshtë:	Pikëzimi Totali 24 pikë
	1. Përgatitja dhe raportimi: A ka respektuar njësia afatin e paraqitjes së secilit raport të monitorimit në MF? PO/JO	0 – 3
	2. Gjithëpërfshirja: A paraqet secili raport informacionin buxhetor të agreguar në nivel Njësie publike (përfshi të gjitha njësitë shpenzuese)? PO/JO	0 – 3
	3. Mbulimi: A paraqet raporti analizën e performancës financiare dhe jo financiare në nivelin e programit për të gjitha zërat e buxhetuar? PO/JO	0 – 3
	4. Mbulimi: A paraqet raporti analizën e performancës financiare për projektet e mëdha kapitale në nivel angazhimi dhe shpenzimi? PO/JO	0 – 3
	5. Krahaseshmëria: A jep informacion të krahasueshëm me buxhetin fillestar, përveç atij të rishikuar/operativ? PO/JO	0 – 3
	6. Plotësia: A ka paraqitur njësia setin e plotë të anekseve të gjeneruara nga AFMIS/SMBV? PO/Pjesërisht/ JO	0 – 3
	7. Krahaseshmëria dhe Plotësia: A janë plotësuar anekset me treguesit faktikë të performancës dhe produkteve kundrejt atyre të planifikuara? PO/Pjesërisht/JO	0 – 3
	8. Publikimi: A publikohet raporti i monitorimit të buxhetit në web-in e Njesisë? PO/JO	0 – 3
Përshkrimi i metodës së matjes	Çdo NJQQ dhe NJQV vlerësohet si më lart për çdo raport të paraqitur nga 0 pikë deri në 3 pikë referuar numrit total të raporteve të monitorimit të buxhetit (Raportet e monitorimit të buxhetit përgatiten mbi baza 4 mujore, pra për llogariten 3 raporte në 1 vit kalendarik). P.sh kriteri 1: nëse njësia ka paraqitur në afat 2 raporte gjatë vitit raportues, vlerësohet me 2 pikë, ose 0 pikë nëse nuk ka paraqitur në afat asnjë raport). E njëjta logjikë ndiqet për secilin kriter. Pas vlerësimit si më lart, njësia vlerësohet për këtë tregues me 0 pikë, 1 pikë, 2 pikë, 3 pikë dhe 4 pikë, në varësi të peshës specifike që zënë pikët e njesisë ndaj totalit prej 24 pikë, të shprehur në % dhe konkretisht:	
	%	Pikëzimi
	Mbi 90%	4 pikë
	75% - 90%	3 pikë
	50%-75%	2 pikë
	25% - 50 %	1 pikë
	nen 25 %	0

12. Treguesi i Performancës	Paraqitja, nënshkrimi dhe respektimi i afatit kohor të dorëzimit të pasqyrave financiare sipas kuadrit ligjor në fuqi	
Përshkrimi i Treguesit	Tregues i përputhshmërisë, mat respektimin e afatit kohor të përgatitjes, nënshkrimit, dorëzimit në sistemin e thesarit, si dhe plotësimin e kriterit të plotësisë, krahasueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes sipas kriterëve të vendosura nga MF për paraqitjen e Pasqyrave Financiare Vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme.	
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Sistemi financiar i qeverisë SIFQ dhe pasqyrat financiare individuale dhe të konsoliduara që dërgohen në MF nga njësitet e qeverisjes së përgjithshme (kontroll formal i PFV mbi bazë liste kontrollesh).	
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për thesarin	
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore	
Referenca	PEFA PI-29.1 dhe PI-29.2 Pasqyra Financiare të kompletuara Udhëzimi nr. 8, datë 20.03.2018”, “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”	
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit		Pikëzimi Totali 10 pikë
	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për raportimin financiar mbi përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të treguesit.	Totali 10 pikë
	1. A ka respektuar njësia afatin kohor të dorëzimit të PFV në MF? PO/JO Verifikim vetëm tek pasqyrat e nivelit NJQP	1
	2. Gjithëpërfshirja: A përfshijnë pasqyrat financiare të konsoliduara të gjitha njësitet shpenzuese të NJQP? PO/JO Verifikim vetëm tek pasqyrat e nivelit NJQP	1
	3. Saktësia bazë: A ka rakordim të pasqyrave financiare (brenda dhe midis tyre)? PO/JO Ky verifikim bëhet fillimisht në degë thesari për pasqyrat individuale dhe më pas në pasqyrat e konsoliduara.	1

	4. Plotësia: A japin informacion të detajuar NJQP në shënimet shpjeguese (PO/JO) sipas kërkesave ligjore, lidhur me: - detyrimet e prapambetura? - transfertat brenda njësisë publike? - transfertat midis njësive publike? - llogaritë e pritjes dhe llogaritë rregulluese në bilanc? - për problematikat lidhur me menaxhimin dhe zërat materiale të aktiveve të njësisë? - për diferencat midis kontabilitetit buxhetor dhe kontabilitetit financiar të shpenzimeve? Mund të bëhet në të dyja nivelet verifikimi për shkurtim kohe të konsolidimit.	0 - 6
	5. A ka opinion të auditimit të jashtëm, ose a janë dorëzuar pasqyrat për auditim brenda afatit ligjor? PO/JO	1
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues do të matet bazuar në analizimin me detaje të përmbushjes së kriterëve ligjore dhe paraqitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore me qëllim përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Vlerësimi do të matet me shumatoren e pikëve pas vlerësimit për secilin kriter. Njësia vlerësohet me 0 pikë nëse nuk përmbush asnjë kriter dhe me 10 pikë nëse përmbush të gjitha kriteret.	

13. Treguesi i Performancës	Hartimi me cilësi i Planit të Veprimit të MFK-së dhe paraqitja sipas detyrimeve ligjore
	Treguesi mat respektimin e paraqitjes së tij sipas detyrimeve ligjore dhe cilësinë e përmbajtjes së Planit të Veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së në njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Plani vjetor për ngritjen e sistemit të MFK-së i hartuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme në përputhje me të gjitha mangësitë e evidentuara gjatë implementimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, do të shërbejnë për monitorimin e këtij treguesi edhe monitorimet e kryera në vend dhe raportet e AB-së dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH). Pikat e fokusit (kriteret) janë si më poshtë vijon: - Respektimi i afatit kohor për dorëzimin e Planit të Veprimit; - Aktivitetet e planifikuara për t'u ndërmarrë me qëllim zgjidhjen e mangësive të zbuluara gjatë përgatitjes së raporteve vjetore mbi funksionimin e sistemit të MFK dhe aktivitete për adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së; - Aktivitete që ndërmerren për të zgjidhur gjetjet dhe rekomandimet e AB-së; - Aktivitete që ndërmerren për të zgjidhur gjetjet dhe rekomandimet e KLSH.
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së

Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore			
Referenca	Udhëzimi nr.2 dt-26.1.2024 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për funksionimin e sistemit të KB-në-NJP”			
	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së mbi përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të treguesit.	Pikëzimi Totali 4 pikë		
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	- Njësia plotëson kriteret	4		
	- Njësia plotëson kriteret, por ka nevojë për përmirësime	3		
	- Njësia i plotëson pjesërisht kriteret	2		
	- Njësia nuk i plotëson kriteret	1		
	- Njësia nuk ka raportuar	0		
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues do të matet bazuar në analizimin me detaje të përmbushjes së kriterëve ligjore dhe përmbajtjes cilësore të Planit të Veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së lidhur me katër pikat e fokusit të sipërcituara. Vlerësimi do të jetë me 1 pikë për çdo kriter të përmbushur nga njësia publike.			

14. Treguesi i Performancës	Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm	
	Raporti mbi zbatimin e kontrollit të brendshëm konsiderohet të jetë gjithëpërfshirës nëse përfshin statistika, informacion mbi statusin e implementimit të kontrollit të brendshëm në njësitë e sektorit publik dhe përfshin të gjitha njësitë e varësisë që kanë detyrimin ligjor për zbatimin e kërkesave të kontrollit të brendshëm	
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Deklarata dhe Raporti për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të jetë hartuar me cilësi dhe depozitimi i tyre brenda afateve kohore të përcaktuara.	
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së	
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore	
Referenca	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. Udhëzimi nr.2 datë 26.01.2024 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për funksionimin e sistemit të KB-në-NJP”	
	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së mbi përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të treguesit.	Pikëzimi Totali 4 pikë
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	- Njësia plotëson kriteret	4
	- Njësia plotëson kriteret, por ka nevojë për përmirësime	3

	- Njësia i plotëson pjesërisht kriteret - Njësia nuk i plotëson kriteret - Njësia nuk ka raportuar	2 1 0
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues do të llogaritet bazuar në analizimin dhe gjykimin profesional të specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së mbi përmbushjen e kriterëve ligjore, përmbajtjen cilësore të Deklaratës dhe Raportit për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në të cilin përfshihen: - informacion mbi statusin e implementimit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike; - informacion i konsoliduar duke përfshirë të gjitha njësitë e varësisë (nëse ka). Vlerësimi do të jetë përkatësisht me 1 deri në 3 pikë për cilësinë e paraqitjes dhe përmbajtjes së Deklaratës dhe Raportit për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe me 1 pikë për kriterin e respektimit të afatit kohor të depozitimit të këtyre dokumenteve.	

4 Grupi i treguesve për matjen e efektivitetit të mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale.

15. Treguesi i Performancës	Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë filozofinë dhe stilin e punës së drejtuesit, mënyrën se si drejtuesi shpërndan detyrat dhe ngarkon përgjegjësitë në njësi.
	Ky tregues vlerëson se në çfarë mase dhe se sa shpesh njësitë publike përmbushin kriteret themelore të përgjegjësisë menaxheriale. - Njësia publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike; - Njësia publike ka miratuar një strukturë organizative të përshatshme me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj; - Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga informacioni i përfshirë në pyetësonin e vetëvlerësimit të dërguar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme miratuar me udhëzimin nr.2, datë 26.01.2024 “Mbi paraqitjen e deklaratës vjetore për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”. Fokus: Parimet e Kontrollit të brendshëm që lidhen me komponentin bazë të Mjedisit të kontrollit.
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore

Referenca	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Metodologjia PEFA 2016		
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së mbi dokumentacionin justifikues të paraqitur në pyetësorët e vetëvlerësimit, të lidhur drejtpërdrejtë me elementët bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale dhe mbi përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të treguesit. Gjithsej 44 pyetje me përgjigje PO/JO.		
	Numri i përgjigjeve pozitive /numrit total të kriterëve të komponentit.	%	Pikëzimi Totali 4 pikë
	- Njësia plotëson kriteret	mbi 90%	4
	- Njësia plotëson kriteret, por ka nevojë për përmirësime	75-89%	3
	- Njësia i plotëson pjesërisht kriteret	50-74%	2
	- Njësia nuk i plotëson kriteret	25-49%	1
	- Njësia ka mangësi të theksuara	0 -24%	0
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues do të llogaritet bazuar në analizimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit, gjithsej 44 kërkesa/pyetje për komponentin e aktivitetit të kontrollit, dhe dokumentacionit justifikues të evidentuar në këta pyetësorë. Vlerësimi do të kryhet në bazë të % së pyetjeve me përgjigje pozitive kundrejt totalit të pyetjeve të komponentit të parë. Merr pikë maksimale njësia që ka përmbushur mbi 90% të kërkesave. Vlerësohet me 0 pikë, konsiderohet me dobësi të theksuara sistemi i njësisë që ka përmbushur deri 24% të kërkesave. Sipas logjikës së tabelës vlerësimi me pikët e ndërmjetme.		

16. Treguesi i Performancës	Menaxhimi i riskut është pjesë integrale e veprimtarisë së njësisë pubike
	Ky tregues vlerëson se në çfarë mase dhe se sa shpesh i vlerëson risqet njësia publike në përmbushje të përgjegjësisë menaxheriale. Fokusi janë Parimet e Kontrollit të brendshëm që lidhen me komponentin e menaxhimit të riskut. - Njësia Publike identifikon objektivat dhe analizon risqet për arritjen e objektivave. - Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve; - Njësia i dokumenton risqet, ka plane veprimi dhe raporton për menaxhimin e tyre.
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga informacioni i përfshirë në pyetësorin e vetëvlerësimit të dërguar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme miratuar me udhëzimin nr.2, datë 26.01.2024 “Mbi paraqitjen e deklaratës vjetore për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”. Fokus: Parimet e Menaxhimit të Riskut
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së

Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Metodologjia PEFA 2016		
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Analiza dhe gjykim i profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së mbi dokumentacionin justifikues të paraqitur në pyetësorët e vetëvlerësimit, të lidhur drejtpërdrejt me elementët bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale dhe mbi përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të treguesit. Gjithsej 17 pyetje me përgjigje PO/JO.		
	Numri i përgjigjeve pozitive /numrit total të kriterëve të komponentit.	%	Pikezimi Totali 4 pikë
	- Njësia plotëson kriteret dhe menaxhon me sukses risqet e njësisë	mbi 90%	4
	- Njësia plotëson kriteret dhe menaxhon me sukses të paktën dy risqe kryesore	75-89%	3
		50-74%	2
	- Njësia i plotëson pjesërisht kriteret	25-49%	1
	- Njësia nuk i plotëson kriteret	0 -24%	0
- Njesia ka mangësi të theksuara			
Përshkrimi i metodës së matjes dhe vlerësimi	Ky tregues do të llogaritet bazuar në analizimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit, gjithsej 18 kërkesa/pyetje për komponentin e menaxhimit të riskut, dhe dokumentacionit justifikues të evidentuar në këta pyetësorë. Vlerësimi do të kryhet në bazë të % së pyetjeve me përgjigje pozitive kundrejt totalit të pyetjeve të komponentit të parë. Merr pikë maksimale njësia që ka përmbushur mbi 90% të kërkesave. Vlerësohet me 0 pikë, konsiderohet me dobësi të theksuara sistemi i njësisë që ka përmbushur deri 24% të kërkesave. Sipas logjikës së tabelës vlerësimi me pikët e ndërmjetme.		

17. Treguesi i Performancës	Njësia publike përzgjedh, zhvillon aktivitete kontrolli përmes politikave, procedurave të shkruara
	Ky tregues vlerëson nëse njësia ka procedura pune, aktivitete kontrolli të shkruara për të dhënë siguri të arsyeshme që risqet e përcaktuara gjatë menaxhimit janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm dhe se objektivat janë të arritshme. Ato përfshijnë një gamë veprimesh kontrolluese me karakter parandalues dhe zbulues, korrigjues. Fokusi janë Parimet e Kontrollit të brendshëm që lidhen me komponentet “Aktivitete e kontrollit”.
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga informacioni i përfshirë në pyetësorin e vetëvlerësimit të dërguar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme miratuar me udhëzimin nr.2, datë 26.01.2024 “Mbi paraqitjen e deklaratës vjetore për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”. Fokus: Parimet e Aktiviteteve të kontrollit.

Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Metodologjia PEFA 2016		
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së mbi dokumentacionin justifikues të paraqitur në pyetësorët e vetëvlerësimit, të lidhur drejtpërdrejt me elementet bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale dhe mbi përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të treguesit. Gjithsej 24 pyetje me përgjigje PO/JO.		
	Numri i përgjigjeve pozitive /numrit total të kriterëve të komponentit.	%	Pikezimi Totali 4 pikë
	- Njësia plotëson të gjitha kriteret, të gjitha proceset e punës të shkruara me sisteme informatike funksionale. - Njësia plotëson kriteret më të paktën 50% të proceseve të punës të miratuara nga titullari. - Njësia i plotëson pjesërisht kriteret - Njësia nuk i plotëson kriteret - Njesia ka mangësi të theksuara	mbi 90%	4
		75-89%	3
		50-74%	2
		25-49%	1
0 -24%		0	
Përshkrimi i metodës së matjes dhe vleresimi	Ky tregues do të llogaritet bazuar në analizimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit, gjithsej 24 kërkesa/pyetje për komponentin e aktiviteteve të kontrollit, dhe dokumentacionit justifikues të evidentuar në këta pyetësorë. Vlerësimi do të kryhet në bazë të % së pyetjeve me përgjigje pozitive kundrejt totalit të pyetjeve të komponentit të parë. Merr pikë maksimale njësia që ka përmbushur mbi 90% të kërkesave. Vlerësohet me 0 pikë, konsiderohet me dobësi të theksuara sistemi i njësisë që ka përmbushur deri 24% të kërkesave. Sipas logjikës së tabelës vlerësimi me pikët e ndërmjetme.		

18. Treguesi i Performancës	Njësia publike përzgjedh, zhvillon sisteme të informacionit dhe komunikimit.
	Ky tregues vlerëson nëse njësia ka procedura pune dhe politika të shkruara për të dhënë siguri të arsyeshme që sistemet e informacionit dhe komunikimit funksionojnë në mënyrë efektive. Fokusi janë Parimet e Kontrollit të brendshëm që lidhen me komponentin “informacioni dhe komunikimi”:
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga informacioni i përfshirë në pyetësorin e vetëvlerësimit të dërguar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme miratuar me udhëzimin nr.2, datë 26.01.2024 “Mbi paraqitjen e deklaratës vjetore për funksionimin e sistemit të

	kontrollit të brendshëm”. Fokus parimet e Informacionit dhe komunikimit.		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Metodologjia PEFA 2016		
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Analiza dhe gjykim i profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së mbi dokumentacionin justifikues të paraqitur në pyetësorët e vetëvlerësimit, të lidhur drejtpërdrejtë me elementët bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale dhe mbi përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të treguesit. Gjithsej 13 pyetje me përgjigje PO/JO.		
	Numri i përgjigjeve pozitive /numrit total të kriterëve të komponentit.	%	Pikëzimi Totali 4 pikë
	- Njësia plotëson të gjitha kriteret, të gjitha proceset e punës të shkruara me sisteme informatike funksionale.	mbi 90%	4
	- Njësia plotëson kriteret me të paktën 75-89% të proceseve të punës të miratuara nga titullari.	75-89%	3
	- Njësia plotëson kriteret me të paktën 50-74% të proceseve të punës të miratuara nga titullari.	50-74%	2
	- Njësia plotëson kriteret me të paktën 25-49% të proceseve të punës të miratuara nga titullari.	25-49%	1
	- Njësia i plotëson pjesërisht kriteret	0 -24%	0
	- Njësia nuk i plotëson kriteret		
	- Njësia ka mangësi të theksuara		
Përshkrimi i metodës së matjes dhe vlerësimi	Ky tregues do të llogaritet bazuar në analizimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit, gjithsej 13 kërkesa/pyetje për komponentin informacionit dhe komunikimit dhe dokumentacionit justifikues të evidentuar në këta pyetësorë. Vlerësimi do të kryhet në bazë të % së pyetjeve me përgjigje pozitive kundrejt totalit të pyetjeve të komponentit të parë. Merr pikë maksimale njësia që ka përmbushur mbi 90% të kërkesave. Vlerësohet me 0 pikë, konsiderohet me dobësi të theksuara sistemi i njësisë që ka përmbushur deri 24% të kërkesave. Sipas logjikës së tabelës vlerësimi me pikët e ndërmjetme.		

19. Treguesi i Performancës	Njësia publike përzgjedh, zhvillon sisteme të monitorimit.
	Ky tregues vlerëson nëse njësia ka të përcaktuar tërësinë e proceseve të rishikimit të aktiviteteve të njësisë. Fokus i parimet e Kontrollit të brendshëm që lidhen me komponentin “monitorimit”:

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga informacioni i përfshirë në pyetësorin e vetëvlerësimit të dërguar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme miratuar me udhëzimin nr.2, datë 26.01.2024 “Mbi paraqitjen e deklaratës vjetore për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”. Fokus parimet e monitorimit.		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Metodologjia PEFA 2016		
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e MFKK-së mbi dokumentacionin justifikues të paraqitur në pyetësorët e vetëvlerësimit, të lidhur drejtpërdrejt me elementët bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale dhe mbi përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të treguesit. Gjithsej 13 pyetje me përgjigje PO/JO.		
	Numri i përgjigjeve pozitive /numrit total të kriterëve të komponentit.	%	Pikëzimi Totali 4 pikë
	- Njësia plotëson të gjitha kriteret, të gjitha proceset e punës të shkruara me sisteme informatike funksionale.	mbi 90%	4
		75-89%	3
		50-74%	2
		25-49%	1
- Njësia plotëson kriteret me të pakten 50% të proceseve të punës të miratuara nga titullari.	0 -24%	0	
- Njësia i plotëson pjesërisht kriteret			
- Njësia nuk i plotëson kriteret			
- Njesia ka mangësi të theksuara			
Përshkrimi i metodës së matjes dhe vlerësimi	Ky tregues do të llogaritet bazuar në analizimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit, gjithsej 15 kërkesa/pyetje për komponentin e informacionit dhe komunikimit dhe dokumentacionit justifikues të evidentuar në këta pyetësorë. Vlerësimi do të kryhet në bazë të % së pyetjeve me përgjigje pozitive kundrejt totalit të pyetjeve të komponentit të parë. Merr pikë maksimale njësia që ka përmbushur mbi 90% të kërkesave. Vlerësohet me 0 pikë, konsiderohet me dobësi të theksuara sistemi i njësisë që ka përmbushur deri 24% të kërkesave. Sipas logjikës së tabelës vlerësimi me pikët e ndërmjetme.		

20. Treguesi i Performancës	Zbatimi i rekomandimeve të AB-së
Përshkrimi i treguesit	Ky tregues vlerëson nivelin e përgjegjshmërisë menaxheriale të titullarit të njësisë publike, si dhe impaktin dhe vlerën e funksionit të auditimit të brendshëm, nivelin e integritetit profesional të audituesve të brendshëm, nëpërmjet matjes së nivelit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm nga subjektet e audituara.

Burimi i të dhënave për treguesin e performancës	Të dhënat do të nxirren nga Raportet Vjetore të NJAB-ve, Raportet e ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga titullari dhe dorëzuar në MF;		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB-së		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca ligjore / standardi ndërkombëtar	PEFA, PI 26.4 - Zbatimi i rekomandimeve të auditimit Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm.		
		%	Pikëzimi Totali 4 pikë
Pikëzimi dhe llogaritja Treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB-së; - Raporti (%) numri i rekomandimeve të zbatuara, kundrejt numrit total të rekomandimeve të pranuar zyrtarisht.	>80%	4
		>70%	3
		>50%	2
		10%-50% nën 10%	1 0
Përshkrimi i metodës së matjes	Në numrin e rekomandimeve si në emërues ashtu edhe në numërues, përfshihen rekomandimet e auditimit të brendshëm për njësinë publike të audituar. Në emërues do të përfshihen rekomandimet e auditimit të brendshëm të pranuar nga njësia publike e audituar sipas Planit të zbatimit të rekomandimeve.		

5 Grupi i treguesve për matjen e kapaciteteve dhe cilësisë së funksionit të auditimit të brendshëm

21. Treguesi i Performancës	Sigurimi i shërbimit të Auditimit të brendshëm dhe kapacitetet e AB
Përshkrimi i treguesit	Ky tregues vlerëson nivelin e ofrimit dhe përputhshmërisë së shërbimit të auditimit të brendshëm të njësisë publike me kërkesat e kuadrit ligjor, si dhe nivelin e kapaciteteve profesionale të audituesve të brendshëm që realizojnë shërbimin. Vlerësimi bazohet në plotësimin e katër kritereve: - Në njësinë publike sigurohet shërbimi i auditimit të brendshëm; - Shërbimi i AB-së ofrohet dhe realizohet në përputhje me kërkesat ligjore; - Audituesit e Brendshëm kanë përfunduar programin e certifikimit deri në fund të periudhës raportuese. - Audituesit e Brendshëm ndjekin trajnimet e vazhdueshme profesionale.
Burimi i të dhënave për treguesin e performancës	Të dhënat do të nxirren nga Raportet vjetore të veprimtarisë të auditimit të brendshëm që dërgohet në MF çdo vit nga Titullarët e njësive publike.

Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB-së	
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore	
Referenca ligjore, ose me standardet ndërkombëtare	PEFA, PI 26.1- Mbulimi i funksionit të auditimit të brendshëm Ligji nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”	
		Pikëzimi Totali 5 pikë
Pikëzimi dhe llogaritja e Treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB-së mbi përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të treguesit.	Totali i Pikëve 5
	1. Ka pasur shërbim auditimi Njësia publike gjatë periudhës raportuese? PO/JO Evidenca: minimumi 1 (një) raport auditimi	0 ose 1
	2. Ka pasur minimumi 2 - 3 auditues për mision auditimi gjatë periudhës raportuese? PO/JO	2 ose 3
	3. Raporti në % i AB të certifikuar kundrejt totalit të AB që realizojnë shërbimin	<35% 0 35%-65% 1 >65% 2
	4. Të gjithë AB ndjekin trajnimet e vazhdueshme profesionale	0 ose 1
Përshkrimi i metodës së matjes	Njësia publike do të vlerësohet për secilin kriter të përmbushur, si më lart. Nëse njësia publike nuk ka krijuar NJAB, apo nuk ka siguruar shërbimin e auditimit të brendshëm nga jashtë, por është audituar nga KLSH, ose auditim i jashtëm i autorizuar, gjatë periudhës raportuese, kriteri 1 dhe 2 konsiderohen të përmbushura. Ndërsa dy kriteret 3 dhe 4 nuk do të aplikohen, dhe si të tilla nuk do të konsiderohen në përllogaritje. Nëse njësia publike nuk ka patur asnjë auditim për periudhën as nga funksioni i auditimit të brendshëm dhe as nga KLSH, të gjitha kriteret do të vlerësohen automatikisht me 0 pikë si penalizim për titullarin e njësisë që nuk ka siguruar shërbimin e auditimit të brendshëm sipas nenit 10 të ligjit për AB.	

22. Treguesi i Performancës	Pranimi i rekomandimeve të AB-së
Përshkrimi i treguesit	Ky tregues vlerëson cilësinë e rekomandimeve të auditimit , nivelin e përgjegjshmërisë menaxheriale të titullarit të njësisë publike, nivelin e integritetit profesional të audituesve të brendshëm si dhe vlerësimin e rolit të AB në njësinë publike të audituar.

Burimi i të dhënave për treguesin e performancës	Të dhënat do të nxirren nga Raportet Vjetore të NJAB-ve, Raportet e ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve firmosur nga titullari dhe dorëzuar në MF;		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB-së		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca ligjore / standardi ndërkombëtar	Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm		
		%	Pikëzimi Totali 4 pikë
Pikëzimi dhe llogaritja Treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB-së - Raporti (%) numri i rekomandimeve të zbatuara, kundrejt numrit total të rekomandimeve të pranuar zyrtarisht.	>90%	4
		>80%	3
		>60%	2
		20%-60%	1
		nën 20%	0
Përshkrimi i metodës së matjes	Në numrin e rekomandimeve si në emërues ashtu edhe në numërues, përfshihen rekomandimet e auditimit të brendshëm për njësinë publike të audituar. Në numërues do të përfshihen rekomandimet e auditimit të brendshëm të pranuar nga njësia publike e audituar sipas Planit të Veprimit të zbatimit të rekomandimeve (që plotësohet nga njësia e audituar pas marrjes së Raportit Përfundimtar të auditimit) Në emërues do të përfshihen rekomandimet e dhëna në total nga njësia e auditimit për periudhën raportuese.		

23. Treguesi i Performancës	Natyra e Auditimeve dhe Standardet e Aplikuara
Përshkrimi i treguesit	Ky tregues mat masën e auditimeve që fokusohen në vlerësimin e përputhshmërisë dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme në funksion të menaxhimit të risqeve të njësisë publike, si dhe nëse ka një proces të brendshëm të sigurimit të cilësisë së funksionit të auditimit të brendshëm. Kriteret që vlerësohen janë: - Plani strategjik i auditimit është përgatitur në përputhje me kërkesat ligjore (përfaqëson një univers gjithëpërfshirës dhe miratohet nga titullari). - Masa e mbulimit me auditim të brendshëm në njësinë publike (referuar % së buxhetit të audituar dhe përfshirjes së zërave materiale/domethënës në auditim); - Aktivitetet e AB fokusohen në vlerësimet e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme;

	- Aktivitetet e auditimit plotësojnë standardet profesionale, duke përfshirë fokusin në zonat me risk të lartë; - Ekziston një proces i sigurimit të cilësisë brenda funksionit të AB;		
Burimi i të dhënave për treguesin e performancës	Të dhënat do të sigurohen nga Raportet vjetore të auditimit të Njërive të Auditimit të Brendshëm që dorëzohen në Ministrinë e Financave. Mund të përdoren dhe raportet e publikuara nga KLSH për njësinë publike.		
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB-së		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Referenca ligjore/ standardi ndërkombëtar	<i>PEFA, PI 26.1-Mbulimi me auditim dhe PI 26.2 –Natyra e auditimeve dhe standardet e aplikuara.</i> Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm		
			Pikëzim
Pikëzimi dhe llogaritja e treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB-së.		Totali 10 pikë
	1. A është plani strategjik i AB gjithëpërfshirës dhe i miratuar nga Titullari i njësisë publike? PO/JO		0 ose 1
	2. Raporti (%) i totalit të zërave të buxhetit të audituar, me totalin e buxhetit të njësisë publike.	<25%	0
		25%-50%	1
		50.01% - 75%	2
		>75%	3
	3. Raporti (%) i numrit të zonave me risk të lartë të audituara me totalin e zonave me risk të lartë të njësisë publike.	<10%	0
		10%-50%	1
		>50%	2
	4.1 Raporti Vjetor i Auditimit nuk përmban gjetje, rekomandime dhe opinion mbi sistemin e kontrollit të brendshëm;		0
	4.2 Raporti Vjetor i Auditimit përmban gjetje dhe rekomandime, por nuk ka dhënë opinion mbi sistemin e kontrollit të brendshëm;		1
	4.2 Raporti vjetor jep opinion mbi sistemin e kontrollit të brendshëm		2
	5.1 NJAB nuk ka program të sigurimit të brendshëm të cilësisë;		0
	5.2 NJAB ka Program të sigurimit të brendshëm të cilësisë por nuk zbatohet;		1
	5.3 NJAB ka Program të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe e zbaton në mënyrë periodike;		2
Përshkrimi i metodës së matjes	Ky tregues do të llogaritet si shumatore e pikëve të vlerësuara për secilin kriter si më lart. Në vlerësimin e numrit të zonave me risk të lartë në njësinë publike, NJAB do të bazohet në planet e menaxhimit të risqeve të njësisë publike, si dhe në vlerësimin e riskut nga NJAB		

	përpara auditimit, konkretisht: Numri i zonave me risk të lartë të identifikuar nga NJAB + Numri i risqeve me prioritet të lartë, të identifikuar nga menaxhimi në planet e menaxhimit të risqeve (Çdo PMR përcakton edhe objektivat/proceset që preken nga risqet). Njesia e Auditimit të Brendshëm të njësisë publike vlerësohet me një maksimum prej 10 pikësh nëse plotëson të gjitha kriteret për një funksion efektiv të AB që sjell vlerë të shtuar në qeverisjen e organizatës.
--	---

24. Treguesi i Performancës	Cilësia e përgatitjes së Raportit vjetor të NJAB-ve	
Përshkrimi i treguesit	Ky tregues vlerëson zbatimin e programit vjetor të auditimit dhe cilësinë e raportit vjetor të NJAB-ve, i cili dorëzohet në ministrinë përgjegjëse për financat. Në vlerësim merren parasysh që: - NJAB ka program vjetor të auditimit të miratuar; - Auditimet e programuara janë përfunduar, dëshmuar me raportet e auditimit të shpërndara tek palët e audituara brenda afateve të caktuara; - Raporti vjetor i përmbahet strukturës së përcaktuar në Manualin e AB-së dhe është paraqitur në afatet e përcaktuara në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e AB-së;	
Burimi i të dhënave të treguesit të performancës	Të dhënat do të nxirren nga Raportet Vjetore të NJAB-ve, të cilat duhet të sigurojnë evidencë si më lart.	
Struktura përgjegjëse për nxjerrjen e të dhënave	Struktura përgjegjëse për harmonizimin e AB-së	
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetore	
Referenca ligjore/ Standardi ndërkombëtar	PEFA, PI 26.3 – Zbatimi dhe raportimi i auditit të brendshëm. Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm	
		Pikëzimi
Pikëzimi dhe llogaritja e Treguesit	Analiza dhe gjykimi profesional i specialistëve të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e AB-së.	Totali 6 pikë
	1. A ka NJAB program auditimi për periudhën raportuese të firmosur nga Titullari dhe të përgatitur brenda afateve të përcaktuara në MAB? PO/JO	0 ose 1
	2. Raporti (%) i numrit të auditimeve të përfunduara, ndaj numrit të auditimeve të programuara. Evidenca: Raportet e Auditimit të dërguara tek palët e audituara.	>50% 1 >75% 2 >90% 3
	3. A i përmbahet Raporti vjetor i AB strukturës së Manualit të AB miratuar nga MF? PO/JO	0 ose 1

	4. A është dorëzuar në kohë raporti vjetor i NJAB së bashku me Tabelat përkatëse me të dhënat e kërkuara sipas Manualit të AB në Ministrinë e Financave? PO/JO	0 ose 1
Përshkrimi i metodës së Matjes	Për secilin kriter të përmbushur, NJAB-të vlerësohen si më lart deri në një numër total prej 6 pikësh. Informacioni i paraqitur nga NJAB në raportin vjetor, lidhur me evidencën mbështetëse për vlerësimin e kriterit 2, është subjekt vlerësimi në vend, ose në distancë nga MF, struktura e harmonizimit të AB. Rezultati rivlerësohet/korrektohet me gjetjet e MF.	

Aneksi nr.2 Tabela e raportimit mbi vlerësimin e treguesve të performancës

[illegible]

Aneksi 3. Udhëzues i brendshëm si shembull për mënyrën e vlerësimit të cilësisë së kontrollit të brendshëm në Njësinë e Qeverisjes së Përgjithshme (NJQP)

Ky udhëzim miratohet nga Titullari i NJQP dhe dërgohet për zbatim në të gjitha nivelet e njësisë.

Qëllimi i udhëzuesit është të përshkruajë:

1. Metodologjinë që do të aplikohet nga Nëpunësi Autorizues /Koordinatori i MFK dhe drejtuesit e strukturave të njësisë për monitorimin dhe vetëvlerësimin e veprimtarisë gjatë përmbushjes së objektivave dhe misionit të njësisë _____.

a) Procesi i vetë-vlerësimit përfshin vlerësimin e çdo komponenti dhe parimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) bazuar në pyetësonin e përgatitur nga ministria përgjegjëse për financat, gjetjet e auditimit të brendshëm, konkluzionet e auditimit të jashtëm dhe masat e propozuara apo të ndërmarra nga menaxhimi i lartë për të adresuar dobësitë e identifikuara.

b) Vetëvlerësimi i MFK-së duhet të mbulojë të gjithë _____ (NJQP), përfshirë çdo njësi vartëse dhe në pronësi apo të kontrolluar prej saj.

I. Organizimi i Procesit të Vetëvlerësimit në Njësinë e Qeverisjes së Përgjithshme

2. Procesi i monitorimit të brendshëm në njësinë publike _____, për efekt të vlerësimit vjetor të sistemit të kontrollit të brendshëm, kryhet gjatë periudhës Shtator-Dhjetor të vitit raportues.

3. Për të përmbushur detyrimet sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, Nëpunësi Autorizues ndërmerr veprime për të mbledhur informacionin për raportin e vlerësimit dhe deklaratën e kontrollit të brendshëm. Ky proces përbën në vetvete një vlerësim të veçantë i krijuar për të vlerësuar kontrollin në mënyrë periodike dhe nuk është i integruar në operacionet rutinë të njësisë.

4. Gjatë procesit Nëpunësi Autorizues mund të delegojë përgjegjësitë teknike sipas Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.16, datë 31.12.2024:

a) tek struktura ndihmëse e tij (nëse ka një të tillë në organikë), ose

b) tek struktura që mbulon planifikimin strategjik dhe/ose monitoron performancën e njësisë publike (nëse ka një të tillë në organikë);

c) tek nënkryetari dhe anëtarët e grupit të menaxhimit të risqeve të njësisë publike.

5. Nëpunësi Autorizues nëpërmjet të deleguarit të tij shpërndan pyetësonin e vetëvlerësimit (të ndarë sipas përgjegjësi) drejtuesve të të gjitha niveleve të njësisë me qëllim plotësimin e tij dhe marrjen e informacionit të plotë. Komunikimi për procesin e vetëvlerësimit të njësive të kontrolluara ose në pronësi dhe afatet e raportimit në njësinë kontrolluese, kryhet zyrtarisht nëpërmjet titullarit të NJQP. Në këtë mënyrë NA do t'i përdorë rezultatet për të formuluar një përgjigje të konsoliduar në lidhje me gjithë njësinë e qeverisjes së përgjithshme.

6. Drejtuesit e të gjitha niveleve të njësisë organizojnë punën me stafin e tyre për mbledhjen e informacionit, kërkojnë deklarime me shkrim ose zhvillojnë takime me stafin në vartësi të tyre për të diskutuar progresin e bërë, mangësitë dhe fushat për zhvillim të mëtejshëm. Pyetësoni i vetëvlerësimit shërben si udhëzues. Informacioni i mbledhur në këto takime përbën bazën e përgjigjes për secilën pyetje të pyetësonit.

7. Drejtuesit e strukturave dërgojnë në rrugë elektronike pranë strukturës së deleguar nga NA (pika 4), përgjigjet e tyre të qarta dhe të arësytetueshme për pyetësit shoqëruar me dokumentacionin përkatës mbështetës.

8. Konsolidimi i informacionit të pyetësorëve dhe vlerësimi në nivel NJQP për vitin raportues, kryhet gjatë muajve Janar –Shkurt të vitit fiskal pasardhës. Struktura e deleguar ndihmon NA-në për verifikimin e përgjigjeve, vlerësimin e pyetjeve të pyetësorit bazuar në ekzistencën e evidences mbështetëse dhe konsolidimin e tyre me metoden e vlerësimit të dhënë në seksionin IV të këtij udhëzuesi.

9. Pyetësi i vetëvlerësimit do të shërbejë si bazë për:

a) identifikimin e atyre aspekteve të kontrollit të brendshëm të njësisë në të cilat nevojitet të ndërmerren masa për përmirësimin e sistemit, si dhe ndërtimin dhe monitorimin e Planit të veprimit për Kontrollin e Brendshëm gjatë vitit ose viteve në vazhdim.

b) Hartimin e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e kontrollit të brendshëm të njësisë, i cili dërgohet në Ministrinë e Financave

III. Mënyra e plotësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit

10. Pyetësi i vetëvlerësimit të komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit përbëhet nga pesë seksione që i përgjigjen pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku vetë komponentët përfshijnë gjithsecili disa parime të kontrollit të brendshëm. Për secilin parim janë ndërtuar një grup pyetjesh, në krah të të cilave jepen referenca të dokumenteve koresponduese, konkretisht në rubrikën “Evidenca Mbështetëse”, dokumenta këto që duhet të ekzistojnë në institucion dhe nga të cilat nxirren informacione për t’iu përgjigjur pyetjeve përkatëse. Pjesa e cila plotësohet nga stafi i njësisë është rubrika “Përgjigje e Arsytuar”, në të cilën duhet të kthehet një përgjigje konkrete, të shoqëruara me referencat përkatëse (numë

11. Në procesin e kryerjes së vlerësimit krijohet Dosje shkresore ose elektronike me një kopje të secilit dokument që justifikon përgjigjet e dhëna (skanohet nëse mbahet dosje elektronike). Dosja administrohet nga Koordinatorin e deleguar të MFK, caktuar nga NA.

IV. Mënyra e vlerësimit të pyetjeve dhe komponentëve të MFK

12. Sistemi i kontrollit të brendshëm është efektiv, kur menaxherët e nivelit të lartë kanë siguri të arsyeshme, që njësia publike:

a) Realizon veprimtari efektive dhe efikase, kur ngjarjet e jashtme konsiderohen të kenë një ndikim në arritjen e objektivave ose ku njësia mund të parashikojë në mënyrë të arsyeshme natyrën dhe kohën e ngjarjeve të jashtme dhe zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm;

b) Kupton masën në të cilën aktivitetet menaxhohen në mënyrë efektive dhe efikase, kur ngjarjet e jashtme mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në arritjen e objektivave ose ku njësia mund të parashikojë në mënyrë të arsyeshme natyrën dhe kohën e ngjarjeve të jashtme dhe zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm;

c) Përgatit raporte në përputhje me rregullat, rregulloret dhe standardet e zbatueshme ose me objektivat e specifikuar të njësisë publike;

d) Veprimtaria e saj përputhet me ligjet, rregullat, rregulloret dhe standardet e jashtme në fuqi.

13. Gjatë vlerësimit individual të çdo strukture funksionale / njësie varësie, çdo pyetje merr 0 (zero) ose 1 (një) pikë në varësi të përgjigjes JO/PO e mbështetur me evidencë.

14. Gjatë konsolidimit të përgjigjeve nga ana e strukturës së deleguar për MFK, për çdo pyetje (kur ka disa përgjigje për një pyetje nga drejtues të ndryshëm të njësisë), si rregull do të kryhet vlerësimi i mëposhtëm për efekt të identifikimit të dobësive në kolonën F:

a) Kërkesa konsiderohet e plotësuar nëse mbi 90% e përgjigjeve, për çdo pyetje, janë pozitive. Pra konsiderohet që nuk ka asnjë mangësi ose shumë pak dobësi;

b) Kërkesa konsiderohet e plotësuar pjesërisht nëse 50 - 89% e përgjigjeve janë pozitive. Pra mangësitë e zbuluara vlerësohen si të mesme dhe / ose të ulëta dhe identifikohen si të tilla në kolonën F;

c) Kërkesa konsiderohet e paplotësuar nëse 0 - 49 % e përgjigjeve janë pozitive. Pra ekziston mangësi e madhe në lidhje me funksionimin;

d) Veprohet në të njëjtën mënyrë për vlerësimin, vetëm për përdorim të brendshëm, të secilit parim dhe komponent të menaxhimit financiar dhe kontrollit (pra nëse 50-89% e totalit të pyetjeve brenda një parimi të MFK, konsiderohen pjesërisht efektive, atëherë i tillë konsiderohet plotësimi i parimit përkatës, etj).

15. Pas hartimit të raportit nga NA për situatën e sistemit të kontrollit të brendshëm, duke konsideruar gjetjet e pyetësorit nga procesi i vetëvlerësimit të menaxherëve të njësisë, si edhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, Titullari i NjQP do të deklarohet mbi statusin e sistemit në njësinë publike që përfaqëson:

a) Sistemi i Kontrollit të Brendshëm mund të konsiderohet me efektivitet të lartë, nëse nuk është zbuluar asnjë ose janë zbuluar shumë pak dobësi të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

b). Sistemi i Kontrollit të Brendshëm mund të konsiderohet efektiv ose pjesërisht efektiv, nëse dobësitë dhe mangësitë e zbuluara vlerësohen si të ulëta, ose të mesme, risqet monitorohen dhe nuk janë zbuluar dobësi të rëndësishme dhe ngjarje të dëmshme për njësinë në zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

c). Sistemi i Kontrollit të Brendshëm do të konsiderohet jo efektiv ose me dobësi të theksuara kur ekziston një mangësi e madhe në lidhje me funksionimin e një komponenti ose parimi përkatës, ose në lidhje me komponentët që veprojnë së bashku në një mënyrë të integruar për të gjithë njësinë dhe kjo mangësi ndikon direkt në moszbatimin e mekanizmave bazë të sistemit të kontrollit të brendshëm.

16. Në mbështetje të përgjigjeve të arësyetuara të stafit të njësisë (kolona E e pyetësorit), Struktura e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Financave do të nxjerrë konkluzione mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike mbështetur në vlerësimin sipas Urdhërit të Ministrit të Financave për vlerësimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm në njësitë publike.

Aneksi 4.

PYETËSORI I VETËVLERËSIMIT PËR NJËSITË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	Njësia Publike						
	Emri, Mbiemri i Drejtuesit të Auditimit të Brendshëm dhe adresa e e-mail:						
	Adresa e faqes së Internetit (ku gjendet i bashkëngjitur organigrama e njësisë)						
	Data e plotësimit (sipas protokollit)						
	Periudha e raportimit						
	Përshkrimi i pyetjeve të pyetësit sipas kuadrit rregullator për Auditimin e Brendshëm.						
Nr.	PYETJET	REFERENCA LIGJORE	ARSYETIMI MBI VLERËSIMIN E KRYER	VLERËSIMI			
				Përputhshmëri e plotë	Përputhshmëri e pjesshme	Përputhshmëri në disa fusha	Mospërputhje e plotë
KRITERE TË PËRGJITHSHME PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM							
1	NjAB është ngritur në përputhje me kërkesat e ligjit për auditimin e brendshëm dhe aktet nënligjore.	1. Ligji nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar					
2	NjAB kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e e ligjit për auditimin e brendshëm dhe Manualin e Auditit të Brendshëm (MAB).	1. Ligji nr.114/2015, i ndryshuar; 2. Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB)					
3	Karta e Auditit të Brendshëm është hartuar, miratuar dhe respekton strukturën sipas formatit standard në MAB. Ky dokument përditësohet në rast të ndryshimeve të rëndësishme në kuadrin rregullator të njësisë publike dhe auditimit të brendshëm.	1. Neni 4 i Ligjit nr.114/2015, i ndryshuar; 2. Manuali i Auditimit të Brendshëm.					

4.	NjAB është e pavarur nga ana funksionale, komunikon e paraqet (kartën, planet dhe raportet) në Komitetin e Auditimit (KA) (nëse ka) dhe i miraton tek titullari i njësisë publike.	1. Ligji nr.114/2015, i ndryshuar; 2. Organigrama e njësisë publike					
5	NjAB është e pavarur nga ana funksionale, si dhe komunikon e raporton drejtpërdrejt tek Titullari i Njësisë Publike.	1. Ligji nr.114/2015, i ndryshuar; 2. Akti nënligjor në fuqi për Komitetin e Auditimit.					
6	Audituesit e Brendshëm kanë akses të pakufizuar në dokumentacion, mjete dhe punonjës.	1. Neni 15 i Ligjit nr.114/2015, i ndryshuar;					
7	Audituesit e Brendshëm nuk janë të përfshirë në veprimtari të tjera operationale përveç auditimit të brendshëm.	1. Neni 17 i Ligjit nr.114/2015, i ndryshuar;					
8	Drejtuksi i Auditimit të Brendshëm ndërmerr një proces të përshkallëzuar të shqyrtimit të konflikteve të mundshme të interesit	1. Neni 18 i Ligjit nr.114/2015, i ndryshuar;					
II. REALIZIMI I SHËRBIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM							
9	Struktura e NjAB respekton kërkesat ligjore dhe te SGAB	1. Kuadri rregullator në fuqi për auditimin e brendshëm në sektorin publik (ligji, Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm dhe MAB; 2. Organigrama e njësisë publike					
10	Drejtuksi i Auditimit të Brendshëm dhe audituesit e brendshëm janë emëruar në përputhje me kriteret e punësimit të përcaktuara në kuadrin rregullator	1. Neni 11 i ligjit nr.114/2015, i ndryshuar; 2. Ligji nr.152/2013, i ndryshuar; 3. Kodi i Punës;					
11	NjAB përmbush kërkesat ligjore për trajnimin e vazhdueshëm profesional.	1. Neni 20 i ligjit 114/2015, i ndryshuar;					
12	Veprimtaria e audituesve të NjAB është në përputhje me Fushën II “Etika dhe Profesionalizmi” të Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm, të miratuar nga Ministri i Financave.	1. Urdhëri nr.103, dt 23.07.2025 "Për miratimin e Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm, për zbatim në sektorin publik në Republikën e Shqipërisë"					
III. PLANIFIKIMI STRATEGJIK DHE VJETOR I NJAB							

13	Planifikimi Strategjik i NJAB shqyrtohet dhe vlerësohet nga Komiteti i Auditimit (nëse ka) dhe miratohet nga Titullari i Njesisë Publike.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm; 2. Akti nënligjor në fuqi për Komitetin e Auditimit. 3. Proces verbal i mbledhjes së Komitetit të Auditimit.					
14	Objektivat e Planit Strategjik të NJAB janë të përcaktuara qartësisht dhe në përputhje me objektivat e Njesisë Publike.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm 2. Programi Buxhetor Afatmesem i njesisë publike					
15	NJAB mbulon me auditim të gjitha fushat/sistemet e njesisë publike (njësi varësie dhe drejtoritë pjesë e organigramës së njesisë publike) duke i dhënë prioritet fushave/sistemeve të përzgjedhura sipas nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët).	1. Plani strategjik; 2. Manuali i Auditimit të Brendshëm 3. Kuadri rregullator që përcakton fushat e përgjegjësisë së njesisë publike.					
16	Audituesit e Brendshëm përdorin metodologji të përshtatshme në procesin e identifikimit dhe vlerësimit të risqeve, për të siguruar prioritarizimin e auditimeve mbi bazën e nivelit të riskut të vlerësuar. A merren në konsideratë sugjerimet, opinionet apo propozimet e dokumentuara nga titullari i njesisë publike në identifikimin e risqeve. Gjykimi i tyre është i pavaruar dhe paanshëm.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm 2. Regjistri i riskut dhe strategjia e menaxhimit të riskut të njesisë publike					
17	Risqet që lidhen me objektivat e njesisë publike janë identifikuar dhe vlerësuar drejt nga ana e audituesve të brendshëm.	Manuali i Auditimit të Brendshëm					
18	NJAB kontribon në hartimin e regjistrit të riskut të njesisë publike (nëpërmjet identifikimit të risqeve të vetë NJAB dhe risqeve të reja të identifikuara gjatë veprimtarisë së njesisë publike).	1. Ligji Nr. 10296/2010, i ndryshuar; 2. Manuali i Auditimit të Brendshëm.					
19	NjAB merr në shqyrtim regjistrin e riskut pranë strukturës së audituar, si dhe a jep vlerësim, opinion dhe rekomandim të orientuar në hartimin e regjistrit të riskut dhe përmirësimit të aktiviteteve të kontrollit, me qëllim minimizimin e riskut.	1. Ligji Nr. 10296/2010, i ndryshuar; 2. Manuali i Auditimit të Brendshëm.					

20	Plani Strategjik pasqyron rezultatin e procesit të identifikimit dhe vlerësimit të riskut.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm; 2. Plani strategjik.					
21	Planifikimi Vjetor i NJAB shqyrtohet dhe vlerësohet nga Komiteti i Auditimit (nëse ka) dhe miratohet nga Titullari i Njesisë Publike.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm 2. Akti nënligjor në fuqi për Komitetin e Auditimit; 3. Proces verbal i mbledhjes së KA					
22	Procesi i hartimit dhe miratimit të Planit vjetor kryhet brenda afateve të miratuara. Ky dokument dërgohet zyrtarisht në DH/AB.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm 2. Nr. prot, datë të planit vjetor					
23	Plani Vjetor pasqyron rezultatin e procesit të identifikimit dhe vlerësimit të riskut.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm 2. Plani vjetor					
24	Burimet e nevojshme të NJAB përlllogariten dhe shpërndahen në mbështetje të objektivave.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm.					
25	Ndryshimet në Planin Vjetor argumentohen, shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komiteti i Auditimit (nëse ka), miratohen nga Titullari dhe janë pjesë e dosjes së planifikimit. Ky dokument dërgohet zyrtarisht në DH/AB	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm 2. Akti nënligjor në fuqi për Komitetin e Auditimit; 3. Proces verbal i mbledhjes së KA; 4. Nr. Prot. të ndryshimit të planit					
26	Angazhimet e auditimit kryhen sipas parashikimeve në Planin Vjetor.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm 2. Raporti vjetor i veprimtarisë					
27	Fushëveprimi dhe objektivat e programit të auditimit përfshijnë vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm sipas nivelit të riskut dhe komponentët e MFK.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm					
28	Programi i angazhim auditimit hartohet nga grupi i auditimit dhe miratohet nga Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm. Ky dokument respekton strukturën sipas formatit dhe përmbajtjen sipas kërkesave të MAB.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm					

29	Audituesit e brendshëm identifikojnë saktë kontrollet që minimizojnë risqet, si dhe analizojnë dhe vlerësojnë përshtatshmërinë e mjaftueshmërinë e këtyre kontrolleve.	1 Manuali i Auditimit të Brendshëm					
30	Gjatë angazhimit të auditimit respektohen të gjitha fazat e përcaktuara në MAB.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm					
31	Dosjet e auditimit administrojnë evidencat e përshtatshme për të dokumentuar punën në zbatim të program angazhim auditimit dhe për të mbështetur gjetjet.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm					
32	NJAB në rastet e konstatimit të parregullsive dhe veprimeve që në vlerësimin e audituesve të brendshëm përbëjnë vepër penale, raporton menjëherë tek Titullari i njësisë publike, i cili informon strukturën e Inspektimit Financiar Publik.	1. Neni 12/1 të ligjit nr.114/2015, i ndryshuar; 2. Nr. prot shkresa dërguar inspektimit.					
33	Çdo rekomandim i pasqyruar në raport është i lidhur me gjetjet.	Manuali i Auditimit të Brendshëm					
34	Observacionet/kundërshtitë e subjektit të audituar trajtohen në raportin final dhe janë pjesë e dosjes.	Manuali i Auditimit të Brendshëm					
35	Plani i Veprimit hartohet dhe miratohet nga Titullari i subjektit të audituar dhe dërgohet në NJAB brenda afatit të përcaktuar.	1. Neni 12 i ligjit 114/2015 2. Manuali i Auditimit të Brendshëm					
IV. RAPORTIMI I REZULTATEVE TË NJAB							
36	NJAB ndjek një proces monitorimi të vazhdueshëm lidhur me zbatimin e rekomandimeve të adresuara në njësinë publike.	1. Neni 14 i ligjit 114/2015, i ndryshuar; 2. Manuali i Auditimit të Brendshëm					
37	Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm paraqet analizën vjetore të veprimtarisë tek Komiteti i Auditimit (nëse ka) dhe Titullari mbi qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë dhe angazhimet e auditimit të realizuara në raport me planin.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm 2. Akti nënligjor në fuqi për Komitetin e Auditimit.					

38	Procesi i hartimit dhe miratimit të raportit vjetor kryhet brenda afateve të përcaktuara. Ky dokument dërgohet zyrtarisht në DH/AB.	1. Neni 14 i ligjit nr.114/2015, i ndryshuar; 2. Manuali i Auditimit të Brendshëm					
V. SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË							
39	NJAB a ka Program të Sigurimit dhe Përmirësimit të Cilësisë Vlerësimi i performancës së aktivitetit vjetor të NJAB kryhet duke u bazuar në Indikatorët e matjes së performancës.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm 2. Akti nënligjor në fuqi për Komitetin e Auditimit.					
40	Rishikimi i brendshëm i cilësisë kryhet nga Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm. Për NJAB me strukturë të pa plotësuar rishikimi kryhet nga Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm i NJAB tjetër. Procesi dokumentohet.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm					
41	Vlerësimet/rekomandimet e procesit të rishikimit të brendshëm të cilësisë merren në konsideratë për përmirësimin e punës së NJAB dhe janë pjesë e dosjes së auditimit.	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm					
42	Drejtuesi i NJAB raporton çdo vit tek Titullari i njësisë publike mbi rezultatet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë si pjesë e raportit vjetor	1. Manuali i Auditimit të Brendshëm 2. Raporti vjetor i veprimtarisë					
VI. DOKUMENTIMI I PUNËS AUDITUESE							
43	Dosjet e përhershme/të përkohshme plotësojnë kërkesat e MAB, arkivohen ato sipas legjislacionit në fuqi.	1. Kuadri rregullator në fuqi për aktivitet.					
VLERËSIMI TOTAL							

UDHËZUES

PËR PLOTËSIMIN DHE VLERËSIMIN E PYETËSORIT TË VETËVLERËSIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

I. Mënyra e plotësimit

Pyetësoni i vetëvlerësimit të auditimit të brendshëm është konceptuar të përdoret nga njësitë e auditimit të brendshëm për vetëvlerësimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Pyetësoni përbëhet nga gjashtë seksione që i përgjigjen të gjitha fazave të veprimtarisë së auditimit të brendshëm, sipas Standardeve Globale të auditimit të brendshëm. Për secilin seksion janë përgatitur një grup pyetjesh, bashkëlidhur të cilave janë vendosur baza ligjore dhe dokumentet koresponduese, konkretisht në rubrika “Evidenca Mbështetëse”, ku përcaktohet baza ligjore dhe në pyetje të veçanta dokumentat referuese që duhet të ekzistojnë në njësinë publike, nga të cilat nxirren informacione për t’iu përgjigjur pyetjeve përkatëse. Pjesa e cila plotësohet nga njësitë e auditimit të brendshëm është rubrika “Përgjigje e Arsytuar”, në të cilën duhet të kthehet një përgjigje e argumentuar edhe me dokumentacionet konkrete, të shoqëruara me referencat përkatëse.

II. Mënyra e vlerësimit

Në mbështetje të përgjigjeve të njësisë së auditimit të brendshëm, struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm do të nxjerrë konkluzione mbi efektivitetin dhe efikasitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në njësinë publike.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm është efektive, kur audituesit japin këshilla dhe rekomandime të vlefshme dhe siguri të arsyeshme për titullarët e njësive publike për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, kur:

1. NjAB është krijuar dhe kryen veprimtarinë në përputhje me kërkesat e ligjit për auditimin e brendshëm, Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe Standardet Globale të auditimit të brendshëm;
2. Njësitë publike realizon shërbimin e auditimit të brendshëm (struktura e NjAB, plotësimi i kërkesave ligjore të stafit, audituesit e brendshëm janë të certifikuar ose në proces dhe ndjekin trajnimet e vazhdueshme profesionale);
3. Plani Strategjik dhe vjetor hartohet bazuar në kuadrin rregullator, bazohet në vlerësimin e riskut, është gjithëpërfshirës dhe përcakton objektivat në përputhje me objektivat e njësive publike, Angazhimi i auditimit kryhet sipas procedurave të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm;
4. Raportet e auditimit janë të qarta, të sakta, koncize dhe japin një pasqyrë të saktë për gjetjet, konkluzionet, rekomandimet dhe opinionin e përgjithshëm për sistemet e kontrollit të brendshëm;

5. Përcaktohen indikatorët e performancës dhe hartohet dhe miratohet Programi i Përmirësimit të Cilësisë sipas përcaktimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm;
6. Dosjet dhe dokumentat e veprimtarisë audituese arkivohen sipas legjislacionit në fuqi.

Vlerësimi i cilësisë së veprimtarisë audituese ndahet në katër kategori: përputhshmëri e plotë, përputhshmëri e pjesshme, përputhshmëri në disa fusha ose mospërputhje e plotë:

1. Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të konsiderohet **me përputhshmëri të plotë me kuadrin rregullator** (ligji, Standardet Globale dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm);
2. Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të konsiderohet **me përputhshmëri të pjesshme me kuadrin rregullator** (ligji, Standardet Globale dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm);
3. Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të konsiderohet **me përputhshmëri në disa fusha me kuadrin rregullator** (ligji, Standardet Globale dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm);
4. Veprimtaria e auditimit të brendshëm do të konsiderohet **me mospërputhje të plotë me kuadrin rregullator** (ligji, Standardet Globale dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm).

Lutemi plotësimin me vërtetësi të pyetësorit të vetëvlerësimit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Duhet patur parasysh se pyetësori do të ndihmojë në identifikimin e atyre aspekteve të veprimtarisë së auditimit të brendshëm, të cilat nevojitet të përmirësohen në të ardhmen, ku kërkohet ndërgjegjësim i mëtejshëm mbi rëndësinë dhe efektivitetin e sistemit, si dhe drejtimet për ngritje kapacitetesh të stafit.

Pyetësori i vetëvlerësimit i plotësuar me përgjegjshmëri të plotë duhet t'i dërgohet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, në ministrinë përgjegjëse për financat së bashku me Raportin Vjetor të veprimtarisë.